



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË PARË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 30.01.2020 (e Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari, z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahimimi, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emiri, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, kryetarin, nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, e dimë që se pardje ka ndodhe një vdekje e një polici e sot e kemi dit zije në shej nderi, respekti. Unë ju kisha lut ta nderojmë me një minutë heshtje. Po e shfrytëzoj rastin t’i përshëndes edhe KFOR-in amerikan, të cilët ju bashkëngjiten kësaj seance. Para se të kalojmë në pyetjet dhe përgjigjen, ju njoftoj se konfirmimin e akteve të nxerrura nga Kuvendi Komunal i Vitisë, Zyra Ligjore e MAPL-së, e kemi marr kësaj here, naj kanë rikthyer një akt. Fjala është për vendimin që e kemi nxerr për pronën komunale që e kemi shendrru në pronë publike. Kur të arrim te miratimi i rendit të ditës, besoj që do ta fusim edhe këtë pikë në rend dite. Nëse ka dikush të parashtror pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

z.Idajete Pira: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam një pyetje për drejtoreshën e Arsimit, pse janë marr drut prej shkollës fillore “Halil Alidema” në Pozharan dhe janë dërguar në shkollën e Ramjanit, kur dijet se lende djegëse nuk ka as një metër edhe në shkollën që janë transferuar nxënësit e shkollës fillore “Halil Alidema”. Në shkollën “Kongresi i Manastirit” sipas informatave të nxënësve që vijnë në mesimin në at shkollë dhe prindërve të tyre dhe disa mësimitdhënëseve edhe nxemje nuk ka apo shumë pak funksionon edhe për kundër orarit të shkurt që kanë shtrohet pyetja çfarë kualiteti mun të pritët nga nxënësit e asaj shkolle, kur funksionojnë me këtë orar të shkurtuar. Lus qeverisjen komunale të Vitisë që të bashkëpunoj me Ministrinë e Arsimit për të ndërtuar sa me shpejt shkollën që është në ndërtim që katër vite, për ndryshe nxënësit e Pozharanit janë të detyruar ta lënë shkollën dhe të ikun dikun në shkollat e tjera. Pyetje tjetër është E-kioska në Pozharan, ka një defekt që nuk e di a jeni në dijeni zyrtaret e komunës për sanimin e këtij defekti që po ju kushton qytetarëve me

plaçkitje, pasi që ata po i ndjekin procedurat e rregullta. Fusin monedhat për të nxjerr dokumentet e nevojshme, po nuk mund të shërbehen, ndërsa monedhat i merr E-kioska. Për këtë ka dëshmi fakte dhe video. Pyes, ku shkojnë ato pare, kush i merr ato dhe a do të sanohet ky problem. Kam edhe një shqetësim tjetër për banorët e lagjes “Halabaku”, “Demiri” në Pozharan. Kanë shprehur pakënaqësinë e tyre në lidhje me ndriçimin publik, pasi që janë të vetmit këto dy lagje që ju mungon ndriçimi publik. Po krahas ndriçimit ata kanë nevojë edhe për ndërtimin e trotuareve po në këto dy lagje për shkak të frekuentimit të automjeteve dhe rruga që është shumë e ngushtë, kalimtarët janë shumë të rrezikuar. Një kërkesë të tillë e kanë edhe banorët e lagjes “Bajra”, të cilët gjithashtu kërkojnë ndërtimin e trotuarit, sepse rruga e tyre deri të shkolla dhe dalja në qendër ndikon bajagi larg e me të veçantë është bajagi. Nxënësit e ciklit të ultë çdoherë janë të detyruar të përcjellen nga prindërit ose familjaret e tyre.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! U patëm dakorduar kryesues, që seancën e kaluar si pikë e rendit të ditës të jetë edhe diskutimi për shkollën e Pozheranit, prandaj kur e kemi raportin e kryetarit unë do të flas pak më tepër, duke e shkel rregulloren me mirëkuptim. Po ashtu u patëm dakordu të vie në kuvend edhe rregullorja për bizneset private, që të kenë pushim të dielën, as kjo nuk u ardh, është mirë të ketë një sqarim. Kam dy pyetje për drejtoreshën e Arsimit. Sipas informacioneve të cilat i kam, prapë po kyqem të pagat jubilarë. E kam konfirmuar me katër punojse shëndetësore, që ata janë pagu për pagat jubilarë, ndërsa nëse i referohemi asaj çka na ke thanë, në seancën e kaluar ki thanë që se shëndetësia dhe arsimit janë fonde prej grandit specifik. Si ka mundësi në të njëjtën komunë arsimtarët, profesorët nuk i kanë marr pagat jubilarë, ndërsa punëtorët shëndetësor po. Një pyetje tjetër, e kam konkursin që e keni hap me kontrata me shërbime të veçanta, lidhje me pozitën e sekretarit. E dimë që ai post është i zbrazët, nuk ka punëtor, mirëpo kur e keni bërë detyrat dhe përgjegjësit që do ti bëjë, ai person keni thanë që do t’i ndihmoj sekretarit. Është një kontradiktë në vete, është gabim teknik apo çka keni mendu lidhje me këtë. Si dhe një pyetje për Drejtorin e Shëndetësisë. Objekti i cili ka qenë Qendra e Mjekësisë Familjare në Pozharan, objekti i vjetër, a do t’i ndërrohet destinimi apo ajo ka mbet ashtu. Çka do të ndodhë me këtë?

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë i kam disa pyetje. Një e kam për drejtorin e Shërbimeve Publike. Nëse ka mundësi të na tregoj, sa është numri i deponive ilegale që janë asgjësuar gjatë vitit 2019. E dimë që ka pas bukur një numër të madh. Pyetje tjetër e kam për drejtorin e Inspeksionit. Kemi pas një rast të hedhjes së deleve të ngordhura në rrugën kryesore Germovë-Goshicë. A ka naj informatë dhe a mundet drejtori të na tregon, se a ka naj informatë se kush ka bërë at gjest shumë të pa përgjegjshëm, që ka bërë një veprim të tillë. Për drejtorin e Shëndetësisë. E dimë që sezona ka kalu për vaksina të gripit, sa ka qenë numri i vaksinave që janë ardh dhe janë shpërnda në Komunën e Vitisë, ku dimë që një kategori e personave të moshuar kanë nevojë shume të madhe për këtë.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam dy pyetje për zëvendës kryetarin e komunës, z.Hasan Aliu, pasi që është jurist. Pyetja është, a lejohet që mos mu ditë në këtë sallë, se kush është këshilltar, kush është zyrtar komunal, kush qytetar e kush është ekipi i kryetarit. Unë nuk po e di tashti çka është bërë, a lejohet që të bëhet kjo rrëmujë kështu. Pyetja e dytë. Gypat nga Letnica deri në Viti janë vendos para një viti, cili është shkaku që qytetarët, e tanë qyteti i Vitisë dhe disa fshatra që janë të lidhur me këtë, nuk furnizohen prej atij gypi. D.m.th, e pash që pagesa është bërë për punën që është kryer edhe CDI-ja i ka pagu obligimet e veta, çka duhet pas kësaj pune me bërë na si këshilltar dhe ju si udhëheqës i komunës, a duhet me shpërblye dikun për mos punën që nuk e ka bërë apo duhet me dënu dikun për këtë punë. D.m.th sot krejt Kosova gëzohet që po bjen shi, na u desht mu idhnu që po bjen shi, se sot ujë nuk ka ne viti, edhe kur të vjen vjen i trubel. Ju e dini ma se u bërë bajat kjo temë, po po duhet me përsëri se kjo është papërgjegjësi totale e atyre njerëzve që kanë kry punë dhe ata që e kanë mbikëqyrë, që e kanë pranuar atë punë. Po dyshoj që këtu ka keqpërdorime totale shumë të mëdhaja, që dikun duhet mu dënu.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Beso që është bërë e tepër ky propozimi im për ditën e diell, është hera e 10 që e diskutoj në kuvend. Ne e kemi mbajtur me zotëri Skenderin një diskutim publik me biznese, 95% janë pro këtij propozimi. Hala nuk ka ardhur në Kuvend kjo rregullore. Kërkoj nga kryetari të na jep një përgjigje pse nuk ka ardhur në kuvend. Kam një kërkesë nga banoret e Sadovines së Qerkezve. Ata mi kanë dërguar edhe fotot, është shtrur asfalti në Sadovinen e Qerkezve në rrugën Sadovinë-Trestenik që një vit. Unë kam thanë më herët, që çokollatat e mija kanë afat më shumë se asfalti i Sokolit. Një cilësi shumë e dobët dhe ky asfalt është dëmtuar në gjendje të tmerrshme është. Është dëmtuar ai asfalt në rrugën Sadovinë e Qerkezve – Trestenik. Edhe një informatë zotri Ramiqi, ndoshta ma ka sjellë për investimet, renovimet që janë bërë në shtëpinë e kulturës. Unë po e shoh një cilësi të dobët të renovimeve. A ke ndonjë informatë me na sjell sot në kuvend.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë dhe e kam pa në uep faqen e komunës një shkrim të cilin është bërë nga Zyra e Kryetarit, i cili më është referuar mua për një reagim që e kam bërë në profilin tim në rrjetin social. Shkrimi të cilin e kam bërë ka qenë një shqetësim të cilin e diskutojmë vazhdimisht me qytetarët e Komunës së Vitisë. Për një praktik që kryetari Sokol Haliti e ka shprehur vazhdimisht, kur janë shpërnda ndihmat për familjet skamnore në Komunën e Vitisë, duke i detyruar ata të rreshtohet dhe të fotografohen dhe pastaj të ekspozohen në uep faqen e Komunës së Vitisë. Pra, kryetar, ky ka qenë reagimi im e jo ashtu siç e keni shkruajtur ju në uep faqen e komunës, kinse unë qenkam kundër ndihmës së mërgimtarëve. Është një gjë që e dinë i madh e i vogël, mërgata e ka ndihmuar para luftës, luftën dhe pas luftës, ajo vazhdon të jetë kursi ynë me të cilën ne sot frymojmë jo vetëm në Komunën e Vitisë, po tërë territorin e Kosovës e jo ashtu që ju ma keni deshifru shkrimin tim dhe i keni dhënë krejt tjetër kuptim. Vazhdimisht jeni thirrur se jeni një komunë transparente që jeni komuna demokratike dhe jeni pro zërit të qytetarit. Ju dhe e keni dëshmuar të kundërtën, duke u fshirë komentet e qytetarëve të revoltuar të Komunës së Vitisë, pra me këtë ju e keni mbytur zërin e qytetarëve të Vitisë, duke marrë parasysh faktin që ju me keni targetuar në uep faqen e komunës që i bien ju nuk e keni kthyer uep faqen e komunës ashtu qysh po thuani po e keni kthyer diçka individuale, personale. Unë ju kërkoj që të vazhdoni me punë të sjellni me investitorët të paktën gjatë qeverisjes mandatin e tuaj dyvjeçar, jo si ajo që ka ndodhur me fabrikën e Vineksit, ta zbutni sado pak varfërinë në Komunën e Vitisë dhe të ju ndihmoni mërgimtarëve, se edhe ata i kanë hallet e veta e jo të vazhdoni dhe ta ndalni këtë praktik të dhënies së ndihmës dorë pas dore, deri të dora e juaj, pastaj duke u fotografuar, duke i vendosur qytetarët në pozita të sikletshme.

z.Rasim Terziqi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Një shqetësim të qytetarit, i cili është gyrbetqar dhe pyetje po ja bëj drejtorit të Shëndetësisë, se ato pllakatat që po i shkruni mirë se vini gyrbetqar, po më duket vetëm fallco e në realitet shërbime atyre shume pak po ju ofrojmë. Si është e mundurshme njeri i sëmurë me kancer ka ardhur prej Zvicrës, kërkon oksigjen në ambulanten e Pozharanit, nuk ka pas në ambulanten e Vitisë, nuk ka pas ka shkuar në Kaçanik. Paramendone mu furnizimi me oksigjen, a nëse nuk e ke oksigjenin mundet me përfunduar për 2-3 minuta. Jeta e atij personi paramendone në anenë e kundërt mirënjohje në fejsbuk e kuaqte tu qit fotografi tu dhënë mirënjohje për anëtarët që punon në shëndetësi, a shërbime qytetarit nuk i ofroni asnjëherë. Unë kur bisedova me atë qytetar, më tha mu nuk më duhet pllakata, mire se vini gyrbetqar, mu më duhet me më kry shërbime cilësore, me kry pushimin si njeri. Kam edhe një pyetje tjetër për tek Lagja e Muhagjerëve. Kjo lagje 130 shtëpi nuk kanë fushë sportive, aty janë mbi 100 fëmijë, nuk kanë ku i zhvillojnë aktivitetet sportive. Gjithashtu rrezikoj me ardhur edhe në shkollë, sepse nuk kanë tretuar rrugës. Shumë është rruga me lakesa, shumë janë të rrezikuara fëmijët deri sa të dalin në rrugën kryesore.

Kryetari i komunës z.Sokol Haliti: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë ju falënderoj që bëtë pyetje, u interesuar. Unë do të përgjigjem vetëm në disa pyetje, sepse janë edhe drejtorët këtu përgjigjen. Këshilltarja që ka ngritur dilema tash pas sa muajve për aksionin humanitar, se Vitia me aksionet humanitare as më shumë e as më pak nuk ka bërë, se ju ka bashkëngjitur të gjithë botes humanitare, që për fund vit, për festat e fund vitit i ndihmon atyre që kanë nevojë. Vitia ka bashkëpunuar me të gjithë ata donator që dëshirojnë me ju ndihmu

njerëzve me nevojë, që kanë nevojë për fundvit. Vitia asnjëherë institucionin nuk e ka shpërnda vet, ndihmat. Po nëse thuani për transparencë dhe insistoni për transparenca atëherë bashkë bashkë ka qenë qajo. Ne kemi qenë së bashku me mërgatën, asnjë cent nuk ka qenë e shpenzuar nga buxheti i komunës. Ka qenë donatori individual, vullnetar, sikur krejt botën që ndihmojnë skamnorët. Kjo duhet mu rrit, mu përkrah, sepse kanë nevojë për këtë disa familje. Ne kemi valëru nëpër vite, që 5-6 vite prej 300 fëmijë deri 516 që kanë pas nevojë pa dallime fetare, pa dallime nacionale, tu i përfshi edhe kroatet në Letnicë dhe të tjerët. Te Drejtoria për Mirëqenie Sociale figuron kjo listë. Ne nuk e kemi përdor vetëm këtë listë, kemi punu me organizatat humanitare që punojnë në vitit. Kryqin e Kuq, me shoqatën Nëna Terezë, kemi punu në veçanti me këshillat e fshatrave, sepse këshillat e fshatrave e kanë ditë familjet që kanë tepër nevojë për fund vit që t'i gëzojmë edhe këto familje. Unë mendoj që në këtë formë duhet të organizohem të gjithë, edhe qeveria komunale edhe këshilltarët edhe zyrat, e të gjithë së bashku të ju ndihmojmë këtyre familjeve, e për hir të vërtetës, në këtë rast ne nuk i kemi nda ndihmat, ne kemi bërë vetëm aktin simbolik të fillimit të aksionit në viti së bashku me mërgatën, që ka qenë obligim i yni institucional. Ne duhet t'i bëjmë transparente të gjitha këto, edhe ndihmat për Shqipëri që janë bërë do të jenë transparente. Kryetarët e këshillave të fshatrave, ata i kanë identifikuar ata, e kanë bërë shpërndarjen e ndihmave humanitare, komuna nuk e ka bërë asnjë ndërhyrje asnjëherë as nuk e bën. Ne edhe para dy javë e kemi pas një donatorë skamnorët janë ndihmuar 250 skamnor me pako. Dashtë Zoti ne të ju ndihmojmë edhe me shumë. Ju ftoj bashkë edhe juve, që aksionet që do t'i kemi të jemi së bashku në aksionet humanitare, por me ndal hovin e diasporës tonë, të cilët 63 shtëpi sociale, tash edhe 2 shtëpi i ka nis për pesë vite në viti dhe aksionet humanitare, për shkak se unë kur kam ardh e kam pa një çështje, që ata donator të diasporës janë tu nimu të gjithë, ama janë tu nimu individualisht. Unë kam dëshirë që ata mi bëjnë bashkë me bërë shumë e më shumë kur jemi bashkë na i kemi ndimur deri 516 familje bashkë, e ky është qëllimi im, kur të bëhem bashkë edhe partitë politike, edhe këshilltarët, qeveria, ndihmojmë shumë më shumë, e për transparencë kemi mu angazhu që të jenë edhe kamerat, se mu ndreq shtëpia sociale e mos mu shënu, mos mu evidentua, asaj i thonë jotransparencë. Për stadiumin e Pozharanit, tek muhagjert është përgjegjësi e ekzekutivit të përgjegjshëm për mi kry punët për interes të qytetarëve. Nuk është e lehtë si kur e kemi pas barrën për këto projektet tjera. Unë e di që këshilltari e dinë që fusha sportive është në projektion buxhetor, të cilin projektion e keni miratu ju, e cila fushë do të bëhet tek muhagjert, është e buxhetume e kodume e keni miratu edhe ju.

z.Ekrem Abazi: Nëse nuk e kam ni mirë, kërkoj falje. Thave që qytetarët kanë të drejtë me qenë në kuvend. Edhe unë e di këtë, po qytetarët nuk kanë të drejtë të ulën së bashku me këshilltarët që janë të perzim. A ka ndonjë kuvend, tregoma nëse ka ndonjë kuvend.

Kryetari z.Sokol Haliti: Sot e kemi informatën e punës së kryetarit për viti 2019. Unë sot kam ftuar gjithë qeverinë komunale dhe të gjitha zyrat, për shkak se është informatë e qeveris komunale e kryetarit dhe e të gjitha zyrave, kështu duhet të jetë. Prandaj, i kam ftu të gjithë. Me rastin që e ngriti këshilltari, unë e shikova sallën, unë e pash se në sallë janë këshilltarët komunal, qeveria komunale, në sallë janë zyrat e kryetarit, në sallë janë janë mediat, OSBE-ja, KFOR-i, edhe një qytetar qenka këtu prezent, e i cili mendoj që nuk na pengon kurgja.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka pyetje tjera, po i lus drejtoritë që të përgjigjen.

znj.Fatbardha Emini, drejtoresh e Arsimit: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! U ngritën disa çështje që janë pjesë e sektorit të arsimit. Unë e kuptoj që këshilltarët duhet me ngrit çështje të caktuara, po çështje të cilat duhet të jenë të bazuara. Këshilltarja Idajete Pira ngriti çështjen e nxemjes në Pozharan. E nderume, unë edhe tash morra informatë, që jo që është nxehtë, po edhe dritaret janë të hapura në shkollën "Kongresi i Manastirit". Mundem me shku bashkë tash, së bashku me media, është ngrohtë aty, edhe për arsye se shkolla është me tre ndërrime, edhe nuk është moti i ftoftë, sa që mos me arrit mu ngro shkolla. Ju edhe një ditë i keni pru mediat në gjimnaz, keni thanë që nuk ka radiator. Edhe qaq janë ndi keq, dy media u kthyen prapa dhe nuk e dhanë kroniken, jo ju personalisht po subjekti u juaj, edhe mediat nuk e dhanë, sepse shkolla kishte radiator.

Kjo shkollë është njëra prej shkollave me nxemje që funksionon jashtëzakonisht mirë dhe dru në të gjitha shkollat ka mjaftueshëm dru. Ne jemi një organizatë buxhetore dhe ku e shohim që një shkollë ka tepriçë apo planifikimi ka qenë më i madh se që ka qenë e nevojshme, ndërsa në njërin shkollë planifikimi ka qenë më i ultë dhe shpenzimi është arrit më shumë. Ne jemi një organizatë buxhetore dhe nuk e pengon nëse ne i bartim drutë nga një shkollë në shkollën tjetër. Sa i përket informatës për arsim, e kemi informatën vjetore, ku një prej sfidave e kemi cek që është shkolla fillore “Halil Alidema” dhe mund të debatohet lidhur me riorganizimin, ndërsa të pagat jubilarë për mësimdhënësit, është një kontratë kolektive që ndoshta pa të drejtë i obligon komunat. Është shumë e pa drejtë, për shkak se komunat, sidomos në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë financohen me grande specifike direkt nga Qeveria. E dini që arsimit ndarjen buxhetore e ka për kokë të nxënësve, edhe një prej sfidave që e ka sektori i arsimit, është ramja e vazhdueshme e nxënësve. Dhe pagat jubilarë, ne prej 2019 jemi tu i nda pagat përcjellëse për pensionistët, ndërsa pagat jubilarë qeveria nuk naj ka bartë neve komunave. Është e vërtet që shëndetësia i ka nda për shkak se shëndetësia ka më pak se 200 mësimdhënës, edhe ka pas tepriçë. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve, dhe shumë mirë që ka arrit me e mbulu këtë obligim që e ka, dhe është një përgëzim edhe për sektorin e shëndetësisë, ndërsa ne i kemi 825 punëtorë dhe kemi pas minus në përfundim të vitit, për shkak se buxheti jonë ndahet me kokë të nxënësve dhe është shumë e vërtet që nuk kemi arri me i kry këto obligime. Tashti së bashku kemi arrit me e fillu në procedurë gjyqësore dhe po thuaja se të gjithë, mësimdhënësit janë duke i kërku edhe pse kanë kërku që mos me fillu procedurë gjyqësore për shkak se krijon një shpenzim. U ngrit edhe çështja e sekretarit në gjimnaz edhe seancën e kaluar e kam cek që është pezulluar ashtu qysh e dini krejt, Ligji mbi Zyrtarët Publik edhe unë kam kërku nga Zyra e Personeli, për arsye se sekretari është shërbyes civil dhe Drejtoria e Arsimit nuk ka të drejtë të bëjë rekrutimin e kësaj pozite. Kam kërkuar që të fillohet me procedurë, po Zyra e Personelit mu ka arsyetu, që për shkak të pezullimit të Ligjit mbi Zyrtarët Publik. Nuk kemi mundësi atëherë kam kërku të kemi një zgjidhje, e ata e ka bë përmes një konkursi të thjeshtësuar për 6 muaj, derisa të behet një zgjidhje.

z.Skender Ahmeti, drejtor i Inspeksionit: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! U parashtru disa pyetje, një lidhur me çështjen e ngordhjes së deleve dhe hedhjen e tyre përkaj brezit të rrugës në Gushicë, dukuri e cila na ka shqetësu shumë, sepse është përsërit katër pesë herë me radhë. Kemi intervenu duke i asgjësuar ato dele. Ne kemi dal edhe me një apel, që ai fermer i cili ka ngordhje të deleve të lajmërohet në Drejtorinë e Inspeksionit, dhe ne do të marrim masa, që në mënyrë të pa dëmshme delet e ngordhura edhe të marrim mostra për analizat e gjakut që me e evidentu se prej çfarë smuje po vuajnë, në mënyrë që si institucione ti dalim në ndihmë. Ai nuk është paraqit, në anën tjetër i kam dhënë apel që kjo masë është e ndëshkume dhe në moment që verifikohet do të sanksionohet. Ne kemi pas edhe nga përfaqësues tjerë të asamblesë komunale, që kanë kerku ndimë prej neve. Ju kemi shërby, kam kërku ndimë edhe nga Stacioni Policor në Viti edhe nga qytetarët që të jemi të kujdesshëm me vërejt, se kush po e bën këtë çështje. Deri tash nuk kemi mujt me e verifiku, se kush i ka hudhë, po për fat të mirë për momentin është ndërpre hudhja e deleve. Sa i përket kërkesës së Taulantit për rregulloren që e rregullon orarin e punës për bizneset, të dielën ne e dimë që e kemi majt një debat publik, nuk ka qen bash krejt 90%, po kemi kontravers të diskutimeve lidhur me këtë çështje kemi edhe opinione që thojnë në korrik-gusht të lirohen të punojnë biznese, për shkak se është diaspora këtu dhe unë nuk muj ta sponsorizoj një rregullore e cila nuk është strikte për me i definua çështjet që të zbatohet. Edhe komunat fqinje që e kanë aprovu këtë rregullore po kanë shumë telashe me e zbatu, siç është Komuna e Ferizajt dhe e Gjilanit, dhe thjeshtë është një çështje shumë e ndjeshme për me e zbatu këtë rregullore. Ne jemi tu pranë edhe propozime, se qysh me bë një model me të mirë, po për momentin jemi duke pritur që të bëhet naj far zgjedhje, ndoshta edhe prej nivelit qendror.

z.Basri Aliu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pata disa pyetje, një pyetje ishte për objektin e vjetër të ambulanta e mjekësisë familjare në Pozharan, të cilën pyetje e beri znj.Mirlinda. Objekti i cilin ndodhet, objekti i ambulancës, më herët ka qenë objekt i policisë, prandaj ne nuk mund të bëjmë diçka tjetër, përveç që të ja

kthejmë prapë policisë si pronë e tyre. Pyetje tjetër ishte te vaksinimi, sa është numri i të vaksinuarve ne Komunën e Vitisë. Numri i përgjithshëm i të vaksinuarve në Komunën e Vitisë për moshat e rritura ka qenë 2750, njëherë përveç vaksinimit që e kemi bërë në Qendrën e Mjekësisë Familjare, ekipi i terrenit ka qenë i gatshëm dhe për ata persona të cilët nuk kanë mujt ti marrin shërbimet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare. Ju kemi vaksinuar edhe nëpër shtëpi, ku numri i tyre sillet rreth 200. Një shqetësim tjetër i këshilltarit, Rasim Terziçi, i cili i ngriti lidhur me oksigjenin. Unë i kisha preferu Rasimit, që informatat ti merr prej dorës së parë, nuk është mirë të dezinformohet këtu, sepse e kemi këtu edhe shërbimet e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Pozharan, ku janë dy aparate me oksigjen, ndërsa sa i përket furnizimit nëpër shtëpi, ka mundësi që ka kërkim ai person, ne nuk i dalim ndihmë në këtë mënyrë, prandaj është mirë të merren informatat nga dora e parë e jo të dezinformohen qytetarët.

z.Ibrahim Rama, drejtor i Drejtorisë së Financave: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam pas disa pyetje nga mbledhja e fundit, dhe besoj që Zyra e Kuvendit ju përcjelli me shkrim, e një që nuk e kam përgatit me shkrim, është pyetja e këshilltarit Taulan Haxhiu, lidhur me projektin e renovimit të sallës së kuvendit komunal, për arsye se ka disa vërejtje për të cilat ndoshta edhe shifen me sy, po unë po ja bëj me dije, që ky projekt është ende i pa përfunduar, ky projekt është së bashku me renovimin e objektit të komunës së vjetër dhe atje te rezidenca. Në përfundim të projektit do ta keni edhe informatën me shkrim.

z.Isak Sadiku, drejtor i Administratës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Lidhur me E-kiosken ishte një pyetje. Deshta me ju njoftu, që ne i kemi dërgua dy zyrtarët tonë, nuk ka qenë problemi aty që nuk kemi furnizuar me certifikata blanko, mirëpo shqetësim ka qenë temë termika e cila nuk ka mujt me arrit temperaturën konstante se qyshe është e parapamë me këta dy zyrtarët tonë, kur kanë qenë tash e kanë rregullu, sidomos kur po është ftoftë po e lan derën hapur, e me siguri aty është pengesa.

z.Nexhmedin Jakupi drejtor i shërbimeve publike: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Rreth pyetjes që ishte për deponitë ilegale, siç jeni në dijeni, viti 2018 dhe 2019 nga qeveria lokale e udhëhequr nga kryetari Sokoli, ka shpall vit të ambientit dhe ne si Drejtori e Shërbimeve Publike, seriozisht ju kemi qas kësaj problematike dhe gjatë vitit 2019 kemi eliminu 65 deponi ilegale në bashkëpunim edhe me kompaninë regjionale. Ekohigjiena po ashtu duhet të permednet se gjatë vitit 2018 na si komuna e patëm fitu një grand për performancë në ambient dhe 2019 ka fundi i vitit e kemi realizu këtë projekt që i është kushtu eliminimit të deponive ilegale dhe funksionalizimit të tri deponimeve që janë caktu në lokacione të ndryshme për mbetjet e materialit ndërtimor edhe në këtë projekt janë eliminu mbi 21 deponi ilegale, ndërsa këto deponi që i ka eliminu Drejtoria e Shërbimeve Publike, këto janë të paraqitura edhe në platformën ndreqe pikë com, ku janë mbikëqyr nga kjo platformë, kanë qenë të dhënat e sakta dhe gjendja e përparshme dhe pas largimit të tyre.

z.Idajete Pira: Drejtoresh e nderume, nuk janë dezinformata, po unë kam edhe nënshkrime edhe prej nxënësve edhe prej prindërve, që është shumë ftoftë, mirëpo ndoshta ty të kanë tregu kur u kanë nxehtë. Unë muj me t'i sjellë nënshkrimet edhe të prindërve edhe të nxënësve.

z.Taulant Haxhiu: I nderuar z.Ahmeti, unë që e kam bërë propozimin për me qenë dita e diel ditë pushimi, unë këtë propozim e kam marr nga bizneset me të mëdhaja në Komunën e Vitisë. Ju e dini që unë vij prej biznesit. Kompania im sot ka 80 punëtorë dhe kështu që unë këtë nuk po e thamë për poenat e mi politik, po prej kërkesës së shumë bizneseve, Mediteran, Emicenter, Rekos e shume të tjerë që kanë mbi 400 punëtorë. Në diskutimin publik kam qenë prezent edhe unë, vetëm që Mentor Rexhepi që nuk ka biznes, i cili vjen nga shoqëria civile, u kanë kundër, 95% janë kanë pro që të sjellët kjo rregullore në kuvend. Po nëse ti prapë mendon që shumica janë kanë kundër, ti organizohe edhe një dëgjim publik me të gjithë bizneset e Komunës së Vitisë. 90% propozimin tim bizneset e Vitisë e përkrahin, po ndoshta pse e ka propozu Taulant Haxhiu nuk po sjellët në kuvend dhe mos të jetë që unë e kam sjell këtë rregullore. Kërkoj edhe njëherë nga ti të organizon diskutim publik. Zotëri Ramiçi pse e pranove shtëpinë e kulturës dhe sallën e kuvendit komunal, renovimin jo të kompletuar. Ti e ke ndërtu

shtëpinë tanë, ti shpinë tane a e kishe pranë pa kompletim, jo. Pse po e pranon pronën e komunës të pakompletimit. Qysh e ki maru shpine pasi që je bërë drejtor edhe këtë u kanë deshtë me pranë pasi të përfundon.

z.Sokol Haliti, kryetar i komunës: Vitia ka pas gjithmonë kulturë politike në kuvend, është mirë me ruajt këtë kulturë. Çështja e shkollës së Pozharanit, drejtoresha po e thotë, kjo shkollë është 5 kilometra nga këtu. Ti punon pak me andej, e ty këshilltari i vendbanimit tanë po të thotë, që nuk ka oksigjen, e ti e din që ka oksigjen sepse ti punon aty. Sa i përket propozim rregullores për orarin e punës së bizneseve. At propozim rregullor e kemi bërë në ekzekutivi, e kemi punu, ajo ka dalë në procedurë, unë me ju tregu drejtën as që jam marrë me këtë çështje, sepse nuk kam dëshirë me këtë, është drejtorja për këtë. Në e sjellim atë në kuvend, nëse e miraton kuvendi në e zbatojmë, ju jeni ata që e miratoni, ndërsa propozimin e ka bërë qeveria, e ka bërë pas kërkesave të bizneseve të qytetarëve, se duhet një ditë pushim, edhe unë jam pajtues si kryetar i komunës. Te shkolla e Pozharanit, spekulime para mediave në kuvend komunal. Nuk është mirë me pas, se unë sa e di ti doktorësh je përgjegjëse, dhe për fat të mirë je edhe këshilltare. Ti je edhe opozitare, qu tregojë a ka pas oksigjen.

z.Ibrahim Rama, drejtor i Drejtorisë së Financave: Në pyetjet e disa këshilltarëve, nuk kam qef edhe mu përgjigj, po në pyetjet apo kërkesat që janë me hile, unë përgjigjem nuk e kam këtë problem hiq. Objektet, të gjitha projektet që përfundohen, që janë të planifikuara me buxhet të Komunës së Vitisë, ato pranohen kur të kryhen punët dhe formohet komisioni, dhe ai komision bazë projektin e realizon e kontrollon dhe e pranon. Është procedurë, nuk e pranon as kryetari i komunës, as drejtori, as qeveria komunale, në përgjithësi procedurat e pranimit të projektit të cilat përfundojnë ose nuk përfundojnë e kanë rrugën institucionale të pranimit, kur. Sa i përket kur jam drejtor dhe kush i menaxhon dhe kush i pranon projektet që i bëjnë privatisht, ajo është pyetje personale, dhe me ta bërë me dije ty Taulant, unë drejtor jam prej vitit 1982, ti nuk ki qenë i lem hiq.

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderoj të gjithë. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e KK-së.
2. Informatë për punën e kryetarit të komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2019.
3. Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar-Dhjetor 2019
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores për transparencë në Komunën e Vitisë.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të Vendimit Nr.01-410/03-52, të datës 01.02.2018, të Komitetit për Politik dhe Financa.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të Vendimit Nr.01-410/03-57, të datës 02.02.2018, të Komitetit për Komunitete.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë.

Dhe qysh ju thash, kemi një propozim vendim të cilin e ka kthyer MAPL-ja, vendim që e kemi miratuar në mbledhjen e fundit. Unë ju kisha lutur që edhe këtë të shtim në rend dite, propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me këtë propozim vendim. Përveç këtij propozimi, a ka ndonjë propozim tjetër për rendin e ditës?

z.Jakup Demiri: Kryesues, e kemi pas për këtë seancë edhe informatën nga Drejtorja e Arsimit për shkollën e Pozharanit. Nuk e di pse nuk ka ardhur edhe në KPF-në. Na keni thanë që e sjellni, nuk e di pse nuk e keni prurë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Drejtorin në e kemi informuar përmes e-mailit, po mu me ka thanë që përmes informatës së kryetarit do ta kemi mundësinë me diskutu. Kush është që të miratohet ky rend dite? Nga të gjithë të pranishmit u miratua rendi i ditës me pikën shtesë.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e KK-së.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Informatë (Raport) për punën e Kryetarit të Komunës janar-dhjetor 2019

Kryetari z.Sokol Haliti: I nderuar z.Kryesues i Kuvendit, Të nderuar Anëtarë të Kuvendit, Të nderuar Drejtorë, Përfaqësues të Institucioneve të Komunës, Media dhe Shoqëri Civile!

Me lejon që sot para juve ta paraqes informatën e punës sime dhe të kabinetit tim për periudhën janar-dhjetor 2019, e cila informatë pasqyron një përmbledhje të aktiviteteve të realizuar përgjatë kësaj periudhe. Nuk është e gjitha pse vitit 2019 ka pas shumë aktivitete. Angazhimi yt është faksuar në identifikimin e sfidave, përkatësisht objektivave në qeverisjen e mirë, të përgjegjshme dhe ligjore. Kudër këtyre objektivave na është dashur të matim shumë indikator. Indikatorët e performances kemi pas rezultate, grande për performance shume në 2019 dhe në fund të vitit kemi nënshkru edhe të tjera që i kemi implementu dhe ky grand që është diskut në mes të drejtori dhe këshilltari ka qenë grand i performances që e kemi nxjerr duke e nxjerr pasqyrën e saktë të gjendje. Sipas kësaj sjellë identifikimit planifikimet të implementimit të projekteve, mandej shërbime për qytetar, shërbime publike, situatës në arsim, rregullimit të saj, sanimin e saj në shëndetësi, bujqësi, kulturë, inspektoratin, financave etj. Po në bazën e këtyre të gjeturave, kemi caktu edhe objektivat tona programore për vitin 2019, për secilën drejtori veç e veç, për secilën zyre veç e veç. Secila zyre, secila drejtori e ka rëndësinë e veçantë. Si objektiva themelore kanë qenë ngritja e performances në administratë, duke e shtuar përgjegjësinë dhe llogaridhënien dhe hapësirave të objekteve komunale. Përmirësimi i efikasitetit në shërbime publike, krijimi i parakushteve për zhvillimin e biznesit për investitor, ndërtimi i infrastrukturës fizike në të gjitha lokalitetet e komunës sonë, ngritja e cilësisë në arsim, avancimi dhe zgjerimi i sistemit shëndetësor, shërbime efikase dhe të përgjegjshme administrative, komunikim në mbështetje në fushat e bujqësisë, mbështetja në fushën e sportit dhe rinisë dhe kulturës, mbështetja financiare organizatave të ndryshme jo qeveritare që veprojnë në komunën tone, hartimin dhe aprovimin e akteve të brendshme të komunës, bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe objektiva të aprovuara në agjendën buxhetore për vitin 2019 ,që ka qenë e fundvitit 2018 nga kuvendi komunal. Në sferën e implementimit të projekteve që janë në fazën e tenderimit, gjatë periudhës raportuese do ta përmendi një prej pjesëve të projekteve kapitale, siç kanë qenë, projektet investive të financuara nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2019, kanë qenë rivitalizimi i ujësjellësve një pjesë dhe gypit, asfaltimi i rrugëve rurale një pjesë të madhe të fshatrave, asfaltimi i rrugës Skifteraj-Mogillë dhe Stubëll e Poshtme-Goden, rregullimi i kanalizimeve, gropave septike, rregullimi i rrugëve me zhavor, ndërtimi i treturave, ndriçimi publik, rregullimi i hapësirave gjelbëruese publike, rregullimi i fushave sportive, rregullimi i lumenjve dhe proçkave, rivitalizimi i tyre, hapja e tyre kanaleve që kanë qenë me dëme përmytëse, sidomos dëme bujqësore, ndërtimi i urës në Binçë dhe zgjerimi i *Urës së Kurteshit*, gjithashtu edhe në Sllatinë të Epërme, zgjerimi i urës, rregullimi i rrethojave shkollore, riparimi nëpër shkolla, renovimi i ambulantëve, përfundimi i pjesës së tretë të asfaltimit të rrugës Sadovine e Jerlive – Dardani, rehabilitimi i rrugës Viti – Letnicë që është kry në fillim të viti, ka qenë ende i papërfunduar, zgjerimi i rrugës ka Drobeshi deri të rruga e Mogilles, që ka qenë një pjesë e saj i segmentit të parë, me tretuar me ndriçim, sidomos pjesa e Drobeshit, ndërtimi i rrugës Viti-Binç ka fillu, se quhet sipas kodeve, rruga Viti –Korbliq, ka qenë e vjetër, është projekt i ministrisë, ne kemi arrit deri në Binç, sepse ministria nuk na ka leju me shumë mjete, vazhdimi i punimeve në palestrës sportive, vazhdimi i punimeve në stadium vazhdimi i punimeve edhe në sferën e trashëgimisë kulturore te Mulliri i Vishve, vazhdimi i punimeve në shkollën në Pozheran. Kjo është në dinamik e sipër, unë besoj se për vitin e ri shkollor do të jetë e gatshme, këtë

nuk e ka Ministria e Arsimit, por Ministria e Administratës Publike. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm, sidomos pas aspektit të sigurisë që nuk kemi guxuar nxënësit mi lan në shkollën e vjetër pas tërmetit. Ne e kemi respektu vendimin e inspeksionit për mi larguar nxënësit prej shkolle, prandaj drejtorja ka marr masat e duhura, vetëm po ju them se shkolla e re në Pozheran do të jetë prej shkollave ma të mira me palestër sportive, revitalizimi i ndërtesës së Komunës së Vitisë, rregullimi i infrastrukturës përkaj “Lumit të Moravës”, rregullimi i varrezave të dëshmoreve në Viti, ndërtimi i shkollës në Drobesh, ka shku në dinamikën e paraparë renovimi i shkollës në Stubëll, ka qenë një donacion, fusha ndihmëse në fshatin Sadovinë e Jerlive, asfaltimi i rrugëve Sadovinë e Jerlive-Verban. Këto janë disa punë në pika të shkurtra, për ma shumë i keni të gjitha te pasqyrat në raportin vjetor që e kemi sjellë para jush. Besoj që materialin e keni marr me kohë, për pyetje apo diskutime jam në dispozicion që t’i debatojmë së bashku.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Fillimisht fjalën ja jap shefave të grupeve parlamentare.

z.Ali Bajrami: Pas ekspozesë së kryetarit, i tha të gjitha, vetëm kisha me bë një rikapitulim shumë të shkurtër. Përmbajtja e informatës është e ndarë në tre kapituj, kemi kapitullin hyrës, kapitullin e dytë dhe kapitullin e tretë. Te kapitulli hyrës u prezantuan të gjitha të arriturat dhe punët që janë bërë përmes sllajdeve, është bërë vërtetë një punë e madhe, një punë shumë transparente. Sondazhe me qytetar nuk kemi bërë, por sikur të kishim bërë sondazhe me qytetar, kapshmëria e tyre do të ishte shumë e madhe. Te kapitulli i dytë, kemi punën që e kanë bërë zyrat e kryetarit, gjegjësisht janë 10, edhe personeli 1, gjithsej 11. Puna përgjithshme e tyre është bërë në harmoni me kryetarin dhe të gjitha këto kanë sjell që në periudhën janar – dhjetor të bëhet një punë e tillë, duke ditë me çfarë buxheti disponon Komuna e Vitisë. Te pjesa e tretë kemi punën e ekzekutivit, një ekzekutiv shumë i përgjegjshëm, shumë i angazhuar në punë dhe në kryerjen e punëve me përkushtim. Te investimet isha ndal vetëm te rini, sport, kulturë. Donacionet që janë shpërndarë për klube sportive, shoqëritë kulturo artistike, që në mënyrë të dinjitetshme e kanë bërë mbrojtjen dhe prezantimin brenda Vitisë dhe jashtë saj, por edhe jashtë shtetit. Prandaj me gjithë këtë punë, me gjithë këtë angazhim në Komunën e Vitisë vend për daltonizëm nuk ka.

znj.Mirlinda Sadiku: Është mirë kryetar që mos me dhanë afate, keni premtuar që shkolla Pozheran do të hapet në vitin 2018 në emisionin Jeta në Kosovë. Nuk është bërë. Keni premtuar në shtator të vitit 2019, nuk është bërë, po premtoni tash në shtatorin e ardhshëm. Është mirë që projektet që kanë participim nga niveli qendror mos të jepen afate, se vazhdimisht po dështoni. Njëjtë është edhe me zonën ekonomike, ku sipas dëgjimeve buxhetore është dashtë të kryhet në vitin 2018, a na sot po flasim për raportin janar –dhjetor 2019 dhe ende nuk ka përfunduar. Njëjtë e kemi gjendjen edhe me palestrën sportive, prandaj nuk është mirë kur keni palë të treta të cilat investojnë në komunë, se jo gjithmonë varet nga ju. Unë i kërkova minuta shtesë, kryesuesit me arsye për arsye, se e cekem, se ka qenë pikë e veçantë e rendit të ditës. Ma merr mendja se ka qenë e rëndësisë së veçantë të flitet për fëmijët e shkollës së Pozheranit. Sa i përket raportit, thuhet se Njësia e Auditorit të Brendshëm ka planifikuar të bëjë shtatë auditime, por i ka bërë vetëm gjashtë. Pse ka ndodh kjo, kur kjo zyre udhëhiqet direkt nga ju. Po ashtu në raportin e auditorit të jashtëm, si e gjetur ka qenë implementimi i rekomandimeve në nivelin e ulët. Kam biseduar me Zyrën e Auditorit të Brendshëm, ma kanë konfirmuar këtë diku nga muaji maj. Ato fjalë miradie që i pate për ekzekutivin, pse drejtorat e tu nuk po munden me i implementu ato rekomandime. Ka një mos koordinim dhe mos planifikim të duhur në lidhje me projektimin, menaxhimin dhe implementimin e projekteve kapitale. Pse komuna vazhdon të bëjë aneks kontrata, 5 aneks kontrata i keni bërë në vitin 2019, 5 i keni bërë në vitin 2018. Çka e mbështet konkludimin tim, se nëse menaxhohet mirë dhe nëse planifikohet mirë, nuk ka nevojë për aneks kontrata. Shuma e aneks kontratave është 78 mijë 473 euro. Kjo nuk është pak. Nëse e shikojmë planin e prokurimit, komuna i ka planifikuar diku rrethe 62 mijë euro në hartim të projekteve, 25 mijë euro për mbikëqyrje të projekteve, 20 mijë euro për shqyrtim dhe ekzaminim të asfaltit të betonit. Gjithsej 100 mijë euro shpenzohen nga taksat e qytetarëve. Për me i mbikëqyrë këto projekte kapitale dhe në fund po kemi asfalte të dëmtume, asfalte të harruar dhe pa cilësinë e duhur. Pse atëherë i shpenzoni gjithë ato pare nëse rezultati në teren nuk është i mirë. Po ashtu atë që e ka raportuar Zyra e Projekteve nuk ka dhanë informacione të sakta për periudhën që është raportuar. Nuk japin info të detajuara për pranime teknike, sa projekte nuk i kanë plotësuar kushtet, sa prej tyre nuk janë të cilësisë së mirë dhe cila është qasja e komunës vit pas viti, po ju referohem pasqyrave financiare. Komuna e Vitisë vazhdon të jap paranë publike nëpërmjet

vendimeve gjyqësore, pikërisht te ata operator ekonomik ku pagesat nuk ju bëhen me kohë. Këtu nuk është asgjë në këtë raport, sepse pikërisht nga kjo zyre menaxhohen dhe implementohen ai 2 milion ershi që i ndajmë për investime kapitale. Prandaj është i rëndësishë së veçantë. Një raport nuk kushton asgjë, ne jemi dëshmitar, kemi sjell foto të panumërta edhe nga koleget e mi nga lëvizja dhe asnjëherë nuk janë marr parasysht. Më intereson ta di drejtor i Shëndetësisë, e ki projektin e ministrisë, ku janë punësu 20 punëtorë. A do të vazhdon për vitin 2020, edhe sa punëtor i keni me kontratë me Karitas Kosova. Po ashtu edhe ky projekt, a do të vazhdon në vitin 2020. Drejtor i Shëndetësisë, mund të më gjykoni si të doni, veç që mu mu ka dok shumë një shumë e madhe bazë dokumenteve që kam pas, qasje ne dokumente zyrtare ka rezultu, që një donacion që na u ka ardh nga Suedia ka kushtu 5000 euro mu më ka dokë ka qenë shumë shumë e madhe nuk e di sa është kosto e ati kontingjenti të ndihmave, po kanjëherë bëj pyetje, a ja ka vle. Sinqerisht mu ka dok kosto e madhe, sipas raportit tuaj, drejtor keni bënë kontroll sistematike në shkolla, ku janë ekzaminu 654 fëmij. Sipas raportit të DKA-së, rezulton që Vitia i ka 8061 nxënës, në përqindje i bien vetëm 8%. A ka prioritete prej ma te ndryshmeve, ka nevojë kjo përqindje me qenë ma e lartë. Po ashtu kam pyetje për drejtoreshën e Bujqësisë. Besoj se tash është rehabilituar në vendin e punës edhe me të drejtë Liridona Bislimi ka bërë një reagim në lidhje me shtëpizat që janë atje tek tregu përball kishës. Ato janë thyer, janë demoluar, janë pa mbikëqyrje, pa mirëmbajtje. Çka do të ndodh me ato edhe nuk janë funksionale. Aty janë të vendosura emrat e shoqatave të grave, po nuk janë profesionale. Kanë fillu me u dëmtu. Drejtori i Shëndetësisë, sipas raportit rezulton që nuk operon reparti i gjinekologjisë që nga shkurja në pension e mjekut. D.m.th, e pash aty të kontrollet është zero. Çka po ndodh me këtë repart. Në vend që në 2020 të kishim progres, të paktën të kishim pse jo një 24 orësh, mjekun gjinekolog me ka bënë përshtypje një fjalë që e kishe than aty. Po me siguri e kishe harru aty prej raportit të vitit të kaluar, gjate këtij gjashtëmujori puna ne QKMF krahasuar me të kaluarën ka pas ndryshime të theksuara respektim të orarit dhe cilësi të ofruara. Këtu po bjen në kundërshtim me vetveten, ndoshta ke mëndu në atë kohën kur u caktu doktoresha Vjollcë. Drejtoresh e po bjen në kundërshtim me atë çka e ke thanë para një viti. Mbetet të them me plote të drejtë, se kur kam shku kam pas një rast në familje, nja pesë gjashtë plusa mu kanë bënë aty ne terapi veç një plus ke edhe fuzion mu kanë dasht me ble, ne vitin 2019 pse nuk ka pas monograf mobil e di që keni mbajt ligjërata shume mirë po grat që janë me fëmijë e prej zonave me të largëta rurale nuk kanë mundësi të vini, që janë bënë tri ndrrime tek shkolla e Pozharanit janë anku prindërit janë anku profesorët sepse edhe pedagogjikisht edhe në menyr higjenike nuk i plotesojn kushtet pse nuk po shfrytëzohet shkolla e Qifllakit e keni në dispozicion komuna e ka të kontraktuar operatorin ekonomik për bartje. Keni mundësi me bënë edhe këtë kombinacion, sepse siç e thashë edhe me herët, nuk dihet se kur do të përfundohet shkolla e Pozharanit. Uroj që të jem gabim, ishalla me Shtator të 2020 fillon, mirëpo nga provoja paraprake na kemi një provoj shumë të keqe, që jogjithmonë dalin fjalët ashtu si të thuhe. Shumë shqetësuese drejtoresh. 1100 nxënës ta pinë ujin e kontaminuar, e keni pas urdhër jo rekomandim, po urdhër nga Drejtorja e Inspeksionit, të ndërmerri diçka në këtë aspekt. Po sa i përket rekomandimeve, me plotë të drejtë ne kemi dhënë rekomandime, po nuk i keni marr parasysht. Këtë e ka konfirmuar edhe KDI-ja, drejtoresh, e keni pas kërkesë edhe të protokolluar nga drejtori i shkollës së mesme profesionale, për dy pastrues dhe një roj e natës. Imagjinone, shkolla më shume se 2 milion eurove e me shume se 250 mije laboratorëve, një natë po një natë jo ka roje, plus kur të ja shtojmë që ajo hapësirë është 6777 metra katror, e nuk ka punëtor teknik të mjaftueshëm, pse nuk është marr parasysht një kërkesë e tillë, që ma merr mendja është shumë e rëndësishme. Nuk e di drejtoresh a e din ti, që shkolla profesionale pastrohet me batanije, pikërisht është kjo çështje që kam thanë, që ju ka qenë dashur me naj pru një plan zhvillimor të shkollës, i cili duhet të kalon nëpërmjet kuvendit komunal, e që është obligim me udhëzimin administrativ, e aty do të shifen se ka nevojë më shumë buxhet. Salla e edukimit fizik, jeni në dijeni nja 5-6 herë është ndërru çelësi, së fundi edhe është thy. E kam cek edhe këtu në kuvend edhe nuk është në nivelin e duhur, është e papastër. Për Drejtorinë e Urbanizmit. Në kuvendin komunal ka pas ardh vendimi për me e aprovu për planin zhvillimor komunal, sipas asaj që kam shfletu, është aprovu me 30.03.2018, d.m.th jeni vonu. Në këtë aspekt plani zhvillimor komunal u dashtë me na ardh dikun ka shtatori. Sipas nenit 7, obligim pas 18 muajve e keni me sjell në kuvend për me ja dhënë dritën e gjelbër. Pse nuk ka ndodh kjo?

z.Naim Pira: E kemi një rregullore që e kemi miratu vet ne këshilltarët e kuvendi komunal, e kemi caktu minutazhen, hajde ta respektojmë këtë rregullore, ama jo qysh po vazhdojmë. Po ju lus ta shfrytëzojmë minutazhen sa na takon me rregullore.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! E nisi këtë me se pari me rregullore, që po përmendet rregullorja për rregullimin e orarit të punës në sektorin privat. Rregullorja ka dal ne dëgjim publik. Unë mendoj që duhet me prur në kuvend at rregullore ose le të na njofton që e kanë terjek at rregullore. Ajo çka me preki me së shumti, ke kur i tha kryetari këshilltarit, ani ti. Kjo me preku mu, sepse kjo tregon që kryetari ka tentu ose donë mi kap edhe këshilltarët. Çka lidhet kjo me, “ani ti”. Kjo nënkupton që është e kapt dhe nuk do me lan edhe një zë mu ndëgjju. Shkolla e ftoftë, ne e dimë që është shkolla e ftoftë, po është marre me thanë drejtoresha i ka qu PDK-ja mediat, pse nuk i kemi qu asnjëherë, se sidomos te shkollat jam i kujdesshëm, sepse punoj vet në shkollë, sepse e dimë që mundet me pas defekte najher në shkollë. Kryetari në diskutim foli shumë për donatorët, e kur ta këshyresh në raport i ka vetëm 60 mijë euro. A e din se dikush ku ta nin tu fol thotë, pale çka u bë, a kur të ja këshyr raportin financiar që vjen aty, shihet që 60 mijë euro janë donacione. Pernime është gjynah me fol për donacione, kur nuk kemi muajt kurgja me nxjerr dhe a kanë tepru paret, po nuk teproj bre, se 2 milion euro janë e 2 milion euro firmat e vogla ti qarkullojnë me ka 5 punëtorë. Shqetësim këtë vit që shkoj, kualiteti i dobët i punimeve qe e përcjell punën kryetarit në çdo aspekt, kualiteti i dobët i punimeve në rrugë, kualiteti i dobët i punimeve që po bëhen, kualiteti i dobët që po bëhet këtu para syve tonë në komunë, ku edhe hibercukin e keni shtrur përmis dërrasa. Shumë punime të dobëta. Unë mendoj, që ende nuk e keni bërë një vërejtje ndonjë operatori që ja keni dhanë dhe mendoj se komisioni pranues nuk i ke në nivel ose kanë presion prej juve që të pranohen ose këta nuk e kryen punën e vet, sepse punimet nuk janë duke u kryer mirë. Nuk besoj që ka sy dikush edhe thotë, se u krye një punë mirë të kësaj sale ku jemi. Kur e ke filluar kryetar para 6 vite mandatin, për një vit dreka zyrtare i ke pas 16 mijë euro. Këtë vit i ke 32 mijë euro. D.m.th. 100% e ke rrit shpenzimet në dreka zyrtare. Çështjen e oksigjenit që e përmendi, ajo ka qenë se në fushatë përnjëmend nuk ka pasur, sepse ju ka dhanë nga një person që e ka pas te shtëpia. Shpenzime të derivateve prej 20 mijë eurove që e ke marr mandatin në fillim, këtë vit i ke 45 mijë euro dhe vendime të gjykatave 155 mijë euro që janë paguar këtë vit. Është e dhimbshme për mua, mirëpo keni kujdes, se vendime të gjykatave mbi 2 milion euro ka me ju ardhur tash me pagat jubilarë dhe me kontratën kolektive. Punësimet të kontrolluara 100%. Edhe vitin që shkoj po të them se komuna është e çdo qytetari, komuna është e të gjitha partive, komuna është e gjitha kuadrove që jetojnë në këtë vend dhe nuk janë vendet e punës vetëm për njerëz të tu. Mendoj se njerëzit që i ke pas të tut, besoj që i ke rehatua, së paku kjo kohë që të ka mbetur së paku barabar le të jetë. Në raportin që e ke paraqitur janë sene që nuk lidhen vetëm një, po e them në faqe tre të raportit, projektet investive të financuara nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2019 dhe në kuadër të saj thotë zgjerimi i rrugës Drobesh – Mogillë. E kemi raportin e vitit të kaluar, ka qenë në faqe 25, po thotë zgjerimi i rrugës Drobesh – Mogillë, projekt 2 vjeçar, projekt i investuar nga niveli qendror. Vitin e kaluar shkruan, ndërsa këtë vit shkruan nga niveli komunal, në raportin tënd shkruan këtë që na i ke sjell edhe zgjerimi i rrugës, e krejt e dini që është bërë u bë shumë e mirë rruga katër krosi a s’di sa e ka bërë me letra. Te Zyra e Projekteve, nuk ke qe me fol, projektin e merr e njëjta kompani e ka firmën tjetër, e merr i realizon projektet 25% të buxhetit, i ka marr i njëjti pronar. Kryetar me tri firma kjo është tmerr kjo është konflikt interesi. Kjo është qe dush me i thanë, kjo është tmerr se ma për Zyrën e Prokurimit edhe Zyrën e Financave, është gjynah me fol, me këto dy zyre merret prokuroria, na nuk po flasim për këto dy zyre hiq. Faqe 22, renovimi dhe ndërtimi i infrastrukturës mbrojtëse të Lumit “Morava”, 400 mijë euro. Gjithë kjo shumë janë maru një 100 shtylla me gurë 400 mijë euro. Po lidhem pak te shëndetësia, se ke cek se edhe nëpër fshatra punojnë mjeket. Në rregull, shembull po e marr Smirën. Mjeku punon një ditë në javë, për një vit i ka pasur 10 vizita mjekësore. Qetu nuk është diçka në rregull, ndërsa viti i ka 52 javë. Tash llogarit 52 herë ka qenë mjeku, vetëm 10 vizita mjekësore. Këtu diçka nuk është në rregull. Te raporti i Drejtorisë së Arsimit nuk po lidhem shumë, por mendoj se në raport u kanë mirë me hy edhe numri i mungesave të nxënëseve, është një problem shqetësues edhe një problem që e kisha përmend. Te kontratat, drejtoresh, lëshimi i kontratave pa afat, ke lëshu mësimdhënëseve që nuk kanë drejtim adekuat. Po lidhem në punësimet në Drejtorinë e Arsimit, sepse e ke degradua arsimin me këto punësime që i ke bërë ti drejtoresh. Te Drejtoria e Bujqësisë. Na e dimë se problemi kryesor është dëmtimi i pyjeve që e ka përcjellë, dhe e dimi se është problem kjo, se pamundësia e shtetit e komunës, problemi është se na e dimë se ngrohja bëhet me dru, prerja e pyjeve është e pandalshme, ndërsa vetëm 74 metra dru janë të konfiskuara gjatë gjithë vitit. Nuk është në nivel kjo drejtori, nuk e dimë qe është duke ndodhur, vetëm po ju them se kjo është shumë pak me krahasua me dëmtimin e pyjeve që është duke u bërë.

z.Njazi Isaku: I nderuari Kryesues, Kryetar, menaxhment, media, të nderuar të pranishëm! Informata një vjeçare e Kryetarit të Komunës për periudhën Janar - Dhjetor 2019, si material i prezantuar në përgjithësi e vëren,

se pjesa dërmuese është përshkrim i punëve të zyrave të kryetarit dhe drejtorive të komunës. Si informatë është e njëjta me vitet tjera për nga struktura e saj. I përgatitur jo profesionalisht, ku janë prezantuar një mori informatash të pa nevojshme (e një pjesë e këtij raporti është edhe i palexueshëm, kështu ju prezantohet Kuvendi Komunal). Askund nuk gjenë cilat janë të arriturat, ngecjet, problemet, por prezantohet material voluminoz, vetëm për të krijuar një përshtypje se është punuar shumë. Te përmbledhja ekzekutive e fjalës se kryetarit, i cili ceku disa objektiva, po ashtu ceku identifikimin, planifikimin dhe implementimin e projekteve. Por, kur lexon materialin, lidhur me objektivat e lartcekur në informatë, nuk gjenë asgjë të shkruar, përveçse punët e përditshme të zyrave dhe drejtorive. Ndërsa, te projektet investive, tanimë të gjithë qytetarët e komunës sonë e dinë dhe e shohin, se në çfarë cilësie bëhen, e me çfarë standarde punohet. Te investimet. Kur shikon prezantimin analitik të investimeve për vitin 2019, në asfaltim të rrugëve, dhe në shtrim me zhavorr të rrugëve keni shpenzuar afërsisht 600 mijë euro në 2019 (ketë e bazojë në prezantimin e analitik të pasqyrave financiare për vitin 2019). Prandaj kjo qeverisje komunale me mandat të dytë e kemi të orientuar vetëm në rrugë, asfaltime e shtrime rrugësh me zhavorr. Nëse një qytetar pyetet, për çka mbahet mend qeverisja e Sokol Haitit, besojë që gjithë qytetarët e kanë përgjigjen, qeverisje e asfaltit. E arsyeja dihet tanimë, fitimi i madh. Zyra, Njësia për Auditim të Brendshëm është prej zyrave me rendësi, kur kihet parasysh se me anë të kësaj zyre, kryetari mundet të kontrollojë gjithë drejtorinë dhe të vendos kontrollin të brendshëm. Por kur shikon mos zbatimin e rekomandimeve të kësaj zyre, është mjaft shqetësuese. Ketë e kemi si e gjetur e Auditorit të Jashtëm për vitin 2017, kemi mos zbatimin e rekomandimeve të auditorit të brendshëm. Aty thuhet, se nga gjithsej 25 rekomandimet, vetëm pesë (5) ishin zbatuar plotësisht, nëntë (9) ishin në proces të zbatimit, ndërsa 11 të pazbatuara. Po ashtu kemi si e gjetur e Auditorit të Jashtëm për vitin 2018, mos zbatimin e rekomandimeve të auditorit të brendshëm. Nga 25 rekomandimet, vetëm 8 janë zbatuar në tërësi, 10 në proces, ndërsa 7 nuk janë zbatuar fare. Mos zbatimin e rekomandimeve nga menaxhmenti dhe kryetari, të jep të kuptosh mosgatishmërinë për kontrollin të brendshëm. Për vitin 2019, ju keni nxjerrë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve sipas Raportit të Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Andaj, në këtë informatë askund nuk gjejmë se sa janë duke u zbatuar rekomandimet e Auditorit. Zyra e Prokurimit. Kjo zyre është e rëndësishme së veçantë, ku kihet parasysh se sipas këtij raporti, në këtë zyre janë zhvilluar 69 prokurime, apo më thjesht, janë nënshkruar 63 kontrata me operatore ekonomik. Në vlerën prej 2,953.808.34 euro për vitin 2019. Por siç duket këtë zyre e kanë vizitua Prokuroria e Shtetit për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Nuk kemi asnjë lajm se çka ka ndodhe. Ndoshta sot kryetari mundet me na njoftu, se çka ju ka ndodhe zyrtareve të kësaj zyre. Avokati Publik i Komunës. Në këtë informatë, përveçse është prezantuar numri i lëndëve gjyqësore për vitin 2018 dhe përshkrimi i tyre, askund nuk gjen cili është suksesi i kësaj zyre, cilat janë të arriturat, sa lëndë janë fituar në dobi të komunës, me përjashtim të një rasti ku është potencuar, se komuna ka fituar rastin në vlerë prej 100 mijë euro. Por nuk kemi asnjë shifër për lëndet që rrezikojnë t'i humbin dhe kostoja financiare e humbjes së këtyre lëndëve. Ndërsa, te pasqyrat financiare për vitin 2019, kemi shpenzime mbi 80 mijë euro nga vendimet e gjykatave. Paga nga vendimet e gjyqësore të marruara nga subvencionet për vitin 2019, kapin vlerën 60 mijë euro. Për këtë arsyeje Zyra Ligjore duhet t'i potencoj edhe këto humbje.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë fillimisht e kam një vërejtje për kryesuesin. Këtë edhe njëherë ja kam pas thanë me herët personalisht, kur po shoh çfarë turri po bëjnë këshilltarët komunal këtu me fol. Unë nuk muj me ja mohu fjalën, mirëpo kryesues, të kisha lut edhe njëherë respektoje rregulloren ose e shfuqizojmë, e tani flasim sa të dojmë, fillimisht jav jep fjalën ka 5 minuta, nëse e kanë të drejtë kryetarët e grupeve parlamentare, tash po flasim, nuk po e respektoj rregulloren hiq, unë kam respekt për kolegët opozitar, kërkesat janë të arsyeshme, ama mos ta lan vetëm seancën e kuvendi këtu me u shpraz, organizoni konferenca me televizione, me gazetar, me shkrime në portale. Po me vjen keq Mirlindë, po mu kanë unë kryesues, ti s' un fol 15 minuta, po vetëm 5 minuta, edhe 2 tjera ta lejoj, ama unë mu kanë kryesues. Kryetar, faleminderit për raportin. Unë i kam do vërejtje të sinqerta dhe besoj të arsyeshme, si: Ura e Kurteshit ose e Pozharanit, që është zgjeru. Ajo urë nuk është zgjeru mjaftueshëm dhe është punu shumë keq. Unë të kisha lut ty personalisht, vet me i hypë kerrit, sot ose kur dush, me dal me këshyrë, bile nuk ka dal asfalti me e mbulu krejt, ka met keq. Atë duhet me e rregullu gjithqysh, edhe nuk e besoj që është bë pranimit teknik. Tek ndriçimi, kujdes me zgjerimin e ndriçimit në Komunën e Vitisë, se kemi rritje shumë të mëdhaja të shpenzimeve vitet e fundit me këto poqa elektrike që po i vendosmi. Unë e pash andej "Moravës", jeni tu i çkyq për shkak se edhe ka pas një problem, nuk keni arrit me I pagu në disa vende, KEDS-si e ka ndal rrymën, sepse nuk kemi luksin që Komuna e Vitisë

me pagu 200 mije euro kosto për shpenzime të rrymës prej buxhetit publik. Rrugët që po shtrohen aty, ku po bëhen trotuaret, në mes të trotuareve edhe asfaltit kur po behet prerja aty, kockat nuk po afrohen deri asfalti ose se paku mu bë me beton, sepse aty po del bari ose therrat, e po metet shumë keq për sy, po edhe uji po mblidhet aty. Te varrezat e dëshmorëve, është bë një renovim. Unë kam qenë, i kam vizitu dy tri herë, sepse e kam afër aty, asnjë prej neve në oborrin tonë, kupëzat qyshe I kanë shtruar aty e qyshe I kanë pre, qyshe I kanë vendos, me I pas bë me pare tona, nuk I kishmi leju mu bë në qat mënyrë. Bile ka edhe aty shkarravina të kockave me ngjithës, aty është punë e ndjeshme të varrezat e dëshmorëve, me leju me bë atë, nëse është bë pranimi teknik. Tek të hyrat vetanake, më erdhi mirë që janë realizu mbi 100% për 2019. Unë nuk muj me bë një krahasim me 2018, se në 2018 e keni pas një plan më të ultë që nuk është kanë real për mu, atëherë e kam than.

z.Rasim Terziqi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kryetari e ka premtu çerdhen në Pozharan, e ka premtu shumë herë këtë. 50 mijë banor Komuna e Vitisë me një çerdhe publike, është jashtë standardi kjo. Ti e dinë që kur ki bashkëpunu me kKomunën e Kihajrit 16 mijë banor, i ka ajo komunë 11 çerdhe publike. Autoambulanca në Pozharan e ki premtu që ki me kry punën 44 mije vizita janë bë në Pozharan e nuk ka autoambulancë. Shpirti për dy minuta del, e nuk pritet deri sa të vjen autoamulanta, fusha ndimse tek Muhagjert, kur u maru fusha në Sadovinë, atëherë u ankojshe nuk ka teren, nuk ka hapësirë tek Muhagjert e tash paska, atëherë nuk ka pas e tash po ka.

znj.Valbona Haziri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Sa i përket raportit të kryetarit, me lejoni të ju përgëzoj për punën që e keni bë ju zotëri kryetar, ju dhe drejtoret e juaj, po gjithashtu edhe zyrat e juaja. Për punën e realizuara, Zyra e Auditorit i ka vlerësuar me notën me të mirë deri më tani, këtë e dimë të gjithë. Gjithashtu sa jemi tek periudha 2019, isha ndal tek Drejtoria e Arsimit, e kisha përgëzu për rritjen e numrit të psikologëve, asistenteve dhe të një mësuesi special që kanë ndiku shumë pozitiv tek nxënësit të cilën I kanë trajtu këta psikolog dhe asistentë. Gjithashtu kërkoj që të rishikohet mundësia e rritjes së numrit të tyre, duke I përfshi të gjitha shkollat e komunës sonë, sepse tash rezultatet janë shumë të kënaqshme tek fëmijët të cilët i trajnojnë psikologët, mësuesit ndihmës si dhe asistentet.

z.Jakup Demiri: Te raporti i kryetarit, i bëj thirrje që projektet që i ka kryer në Komunë të Vitisë, kisha lutë kryetar, dil shikoj vetë, shikojë tash së fundi rrugën që është shtruar Sllatinë –Dardani, mos të flasim ma për rrugën e Pozheranit, që është shtruar vitin e kaluar, rruga prej xhamisë ka Kllokoti, ajo ma tri vite rresht është shtruar. Veç në vitin 2019 dy herë. Nuk e di a kanë pranim teknik a nuk kanë, kisha pas dëshirë me marrë një përgjigje. Një pyetje, më shqetëson te kanalizimi i Smirës, kisha dashtë me ditë, kur do të ketë pranim teknik. Ne mund të shkojmë bashkë me mua dhe ta shikojmë në çfarë gjendje është sot, ngase me insistim të juajin për me vazhdua punimet është në këtë gjendje që është sot, me pas dëgju atëherë këshillin e fshatit, ju kish ra shumë ma mirë edhe atë mbikëqyrësin që ka sugjeruar për me i ndërpre punimet, se ky kanalizim nuk funksionon dhe sot nuk funksionon. Te çerdhet publike, keni premtuar për Pozheran, për Smirë, për Sllatinë edhe një në Viti. Po e them sot, se ma në këtë vit nuk besoj që do të vish dhe sot ta kemi mundësinë të takohemi këtë e ke premtuar vet dhe komuna jonë ka nevojë për çerdhe. Tash po dali te shoqatat humanitare, politika dhe shoqatat humanitare nuk duhet të përzihen. Na jemi dëshmitar të këtij vendi dhe dinë qysh shfrytëzohen gjitha shoqatat për fushat zgjedhore. Unë e di personalisht, emër mbiemër nuk ka shkua me i marr ndihmat, se po qesin fotografi. Kjo e pengon ata që ka me marrë ndihma.

z.Taulant Haxhiu: Desha ta di ky dokument që është bashkëngjit, tash a është dokument i pasqyrave financiare apo raport i kryetarit tash në seancë. Kryetar, asfalti në Fshat të Ri, desha me ditë a u bë pranimi teknik a jo, se ajo ka qenë edhe nëpër portale, se në asfalt ka dal bari. Aty e ka pranuar edhe drejtori juaj si dështim. Kërkoj prej teje të ma japësh. Edhe unë desha të lidhem me shpenzimet për informimin publik, përcjellja e aktiviteteve transmetimi në televizione është 19 mijë e 150 euro. Këtu dua me ditë sa i merr televizioni lokal që është I kontraktuar dhe ku ka shkuar. Pjesa tjetër, dua si informatë me dit këtë ku ka shkuar komplet. Këtu po e shoh dreka zyrtare 31853 euro. Nuk po hy për drekat zyrtare për ditën e mësuesit, e as te Flakadani I Karadakut, për shkak se e ceku Bekimi, dreka zyrtare është 20690 euro. Kjo I bjen se 103 euro në ditë ka pasur dreka zyrtare të kryetarit të komunës edhe I dua fakturat se ku janë harxhuar këto 20690 euro, në cilat restorante të Komunës së Vitisë apo jashtë, se ju edhe te Evropa shkoni shpenzoni dreka zyrtare.

z.Sokol Haliti: Së pari dua ti përgjigjëm të fundit. Unë po të them se ti nuk je shef i imi. Të lutëm mua me tonë urdhërues mos me fol, sepse unë jam duke paraqitur informatën për vitin 2019, për Zyrën e Kryetarit dhe zyrat tjera të kryetarit, kabinetin e kryetarit. A është voluminoz a është i pakët, na e vlerësojmë bashkë. Unë jam

shumë në rrjedhë të këtyre kërkesave, nuk është në rrjedh për me mbuluar defekte është në rrjedhë për shkak se është i përgjegjshëm për shkak se është i interesuar për domenin në interes të qytetarëve është në rrjedh, sepse dëshiron me i demantuar spekulimet edhe ato të tjerat që janë të pavërteta është në rrjedh, sepse dëshiron me informuar ma drejtë në mënyrë që mos me keq informuar qytetarin. P.sh.: kur flitet për dreka zyrtare, e tha shefi i grupit parlamentar, unë për ata i kërkoja kryesuesit, dikush tha që po mungoj në seanca. Jo unë kam qenë në 8 seanca në vitin 2019. Dua me demantua këshilltaren si shefe të grupit parlamentar, se tha 100 mijë euro për hartimin e projekteve, kjo është shumë ma pak. Edhe diçka si shefe e grupit parlamentar, ke pas qasje në dokumentet zyrtare, sa herë ke dashtë një dikaster u dashtë vetëm juve me ju nejt me shërbye, por po të them se e ke qasjen edhe për këtë kjo është shumë ma pak. D.m.th. demantohesh. E dyta, nuk është e vërtet se është përqindja e asfalteve kaq e madhe. E kam përqindjen 22.81%, se muzeu që jemi duke punuar tash nuk është asfalt, ndërtesat, zyrat dhe salla nuk është asfalt, ambienti, ndriçimi nuk është asfalt, zgjerimi me tretuar nuk është asfalt, rrugët bujqësore nuk janë asfalt. Kanalizimi i Smirës është tenderuar në vitin 2013 jo në vitin 2014 pasi që jam ardhur unë. Unë po ju them që nuk është Sokol Haliti që e mbron keqinvestimin e keqplanifikimin e keqmbikëqyrjen, unë i mbroj këto edhe e dinë. Te drekat zyrtare, desha të ju them se nuk është ashtu hiq, se dreka zyrtare edhe derivate Sokol Haliti ma se paku ka harxhuar në 20 vitet e fundit, se akuza pa bazë nuk është e drejtë edhe e ndershme, kjo që thua ti nuk qëndron, se të gjitha drejtoritë i kanë harxhuar 19 mijë euro. Dita e Mësuesit 2340 euro, Flakadani Karadakut është 8870 euro, krejt këto bajnë kjo shumë që po thua ti shpenzimet e derivateve të naftës. Gjeneratori 2644 litra, nxehja 21525 litra, automjetet e komunës 17986 litra, shoqata 1790 litra, shëndetësia 14405 litra, zjarrfikësit 11656 litra. Faleminderit shumë këshilltareve, se megjithatë e pranojnë punën, se viti 2019 ka pasur rezultate dhe suksese. Unë i marrë gjitha ato vërejtje që ishin konstruktive. Mirlinda ka ngritur shumë çështje, e përmende Jeta Xharrën për shkollën e Pozheranit, ajo është një gazetare hulumtuuese, na sot po bisedojmë për informatën e vitit 2019, për punët që i kemi kryer, por po të them, se premtimet jepen për një mandat 4 vjeçar. Unë e kam bërë premtimin për shkollën e Pozheranit, jam duke e realizuar brenda mandatit, kemi me përrurua shkollën aty bashkë. Edhe tjetra, është pavarësuar në mandatin tim, me punën time. Zona ekonomike fare nuk ka qenë premtim, ajo ka qenë ambicie e gjithë neve, ajo është në ndërtim e sipër, është projekt shumëvjeçar, shpresojmë që këtë vit të merr kahëje shumë ma të mirë. Palestra sportive, ju e dini se është projekt trevjeçar, ka qenë premtim edhe ka me realizuar e ngritë edhe çështjen e ambulantes. Unë po e shfrytëzoj rastin të tregoj, se na javën e kaluar kemi marr një autoambulancë të re, është rezultat i përbashkët me qeverinë qendrore, kur e kemi marr pushtetin ka qenë një, tash i kemi 5 autoambulanca. S'kena pas asnjë emergjencë, i kemi bërë dy. E vetmja komunë që i ka dy emergjenca pas Prishtinës është komuna jonë. E përmendi dikush te Shëndetësia 5 mijë euro. Shikoni, sa ka qenë vlera e donacionit qindra mijëra euro. Tjetër, auditori i brendshëm, auditori i jashtëm. Edhe këtu nëse keni vërejtje. Komuna e Vitisë është numër 1 te auditori i jashtëm. Edhe te rekomandimet ne kemi bërë plan veprimi. Premtimet për autoambulancë, për ambulante, për shkollë, unë ja kam dhanë qytetarit. Unë ju kisha lutë të më dëgjoni për hir të korrektësisë dhe demokracisë, ambulanta në Pozheran u ndërtua në vitin 2014, u përrurua në vitin 2015. Kemi ndreq ambulanten e Remnikut, ambulanten e Sllatinës, janë duke e kompletuar, e kam rivitalizuar ambulanten e Smirës dhe disa të tjera. Edhe ambulanten e Pozheranit kemi me kompletua me gjitha që i nevojiten, edhe me autoambulancë. Asfalte të harrnuara, të dëmtuara. Unë ma së shumti jam duke bërë shtytje për me i përmirësuar kualitetin e punëve. Vendimet gjyqësore, avokati është këtu, shumica janë absolute të vjetra, para se me ardhur na, por ato mund me u bë transparente. Shtëpizat te tregu, drejtoresha ka ardhur ma vonë, unë jam ma në rrjedhë, është donacion me UNDP-in, janë bërë të gatshme me GLV-në, kontratat shumë shpejtë, komuna ka treguar vullnet, na e kemi lënë pagesën vetëm një euro për mi stimuluar dhe me rigjeneruar vende të punës, unë besoj se pa u mbajt seanca e ardhshme e kuvendit dhe do ti shini vet. Mungesa e rojeve te shkollat e mesme, duhet me pas edhe këtë parasysh. Ne kemi nevojë shumë për përfaqësim në aspektin teknik, te rojet, te pastruesit, por duhet me pas parasysh se kush e lejon rritjen e numrit të punëtorëve. Unë dhe zyra ime nuk rekrutojmë punëtorë, është zyra e përcaktueme e cila me ligj i bënë senet. Departamenti i memorialëve dhe kompleksi i dëshmorëve, është marr me projektin edhe me mbikëqyrjen ne vetëm, e kemi bërë kërkesën, ata i kanë lëshuar mjetet dhe janë kryer punimet të cilat kanë qenë me paramasë dhe paralogari. Sa i përket çerdheve, është e vërtet që ne kemi premtuar çerdhe për Pozheran, e kam fjalën, na kemi një shkollë që ka vetëm 2/3 nxënisa në Qifllak, për me shndërruar në çerdhe na nevojitet një donator që besoj se e gjejmë. Dikush tha, vetëm 60 mijë euro kanë qenë donacione, që po i them se nuk është ashtu, se vetëm donacioni i DEMOS-it është ma i madh. Prandaj donacione kemi shumë ma shumë. Fusha ndihmese te

Muhaxheret. Po kam dëshirë me ta argumentuar, unë edhe ma herët kam qenë për me dërgua në Pozheran, por kriteri i FFK-së dhe ministrisë ka qenë, nëse nuk është në plan zhvillimor komunal mos me mund, ndërsa tash nuk është duke investuar FFK-ja, tash buxheti i kuvendit komunal që ju e keni miratuar, me propozimin tim jena te financuar edhe neve nuk na ndal askush me ndërtoar fushën në Pozheran. Punimet e projekteve Sllatinë – Dardani. E ke ngritë, shiko, projekti është aty, ingjinerat janë këtu, nëse e ke pa vet, mirë, nëse e ke me të nime, shko shikoje, sikur që nuk jam edhe për kanalizimin në Smirë. Po të pyes, a je për me pranuar teknikisht atë projekt, se unë kam pas debat për këtë punë. Po mundohem me mbyll, por nëse ndonjë përgjigje nuk e kam dhanë, po ju kërkoj falje, por po ju them se ndeshi me shkrim ndeshi kështu jam në dispozicionin e juaj.

z.Basri Aliu: U ngrit disa pyetje dhe disa dilema nga këshilltarja Mirlinda. Po mundohem që të jap përgjigje në ato pikat të cilat i ceki ma herët. Për kontrollet sistematike të nxënësve nëpër shkolla, realisht ne e kemi bërë dhe jemi nisur me një plan të orientuar, i cili është bërë prej eksperteve shëndetësor, që të kontrollohen nxënësat e klasës së 5 dhe të ndahet evidenca e tyre në gjitha parametrat të cilat janë paraparë në kontroll, ku ka qenë ekipi diku prej 8 vetave, ndërsa këtë vit do të fillojmë edhe me klasa të 9-ta. D.m.th. edhe me pëlqimin e prindërve, se kur vin nxënësit nga klasa e pestë në të nëntën, me vërejt ndryshimin. Sa i përket çështjes së vazhimit të kontratës me Kartiasin, ne do të vazhdojmë prapë, se me ndihmën e tyre kemi bërë edhe shërbime ma të mira edhe për qytetarë. Për donacionin, kryetari e përmendi, por do ta arsyetoj pak ma mirë, se ne kemi pasur një marrëveshje me shoqatën Iliria nga Suedia, ku u dashtë na ta paguajmë transportin, ndërsa ata ta sjellin donacionin. Ky donacion kap vlerën diku mbi 100 mijë euro. Kanë qenë mbi 25 shtretër, ku një shtrat kushton mbi 1 mijë euro. Kemi pasur edhe 50 karroca për te hendikepuar, kemi pas edhe shumë elemente të tjera. Për ambulancën në Pozheran. Dua ta ceki edhe njëherë, se e vetmja komunë në Kosovë jemi që mbajmë 24 orshin, a është mirë me dërguar autoambulancën, edhe unë jam për të, por na jemi duke gjetur një modalitet për me dërgua atje. Për fillim do të jetë vetëm për ndërrimin e parë, sepse nëse hymë me dy ndërrime, atëherë na duhen 4 shofer, çka ministria nuk lejon për ngritjen e numrit të punëtorëve.

z.Ekrem Abazi: E dëgjova kryetarin, e kemi bërë këtë e kam bërë atë. Po të them se buxheti nuk është i kryetarit, buxheti ju takon qytetarëve të Komunës së Vitisë. Kryetari me ekipin e vet janë për ta menaxhuar atë buxhet ku ka nevojë ma shumë. Po të pyes kryetar, që diçka prej teje varet p.sh. te Administrata kërkohet sa kanë mirësjellje me qytetar, sa janë efikas në punë, sa rrinë në zyre, nuk rrinë nëpër kafe. Tjetër, e pash në raportin e juaj se i keni anuluar 4 konkurse, a bënë me dit shkaku i anulimit. Unë si qytetar i kësaj komune, dyshoj se anulimi i këtyre konkurseve është bërë për shkak se ju nuk keni mund me vendos personin adekuat që keni dashtë ju me vendos aty. Gjatë vitit 2019 ka pasur shumë konkurse, apo me tregon a ka kaluar dikush që nuk bënë pjesë në klanin tënd me u punësuar, d.m.th. kur hapet konkursi në Komunën e Vitisë, punëtori ka me ardh pas një jave, ja është tu punuar. Veç edhe po ju lus qytetarë se mos konkurroni kot, se punëtorët vetëm sa janë duke punuar. Te çerdhja, kryetar kjo varet prej teje, se këta varësit e tu nuk i ke bash qysh po mendon. Sa i përket asaj se thash janë duke keqpërdorur, unë kam drejt me mendua se janë duke keqpërdorur bashkëpunëtorët e tu edhe a mund me ma përmend një punëtor që e ke marr në punë ti me kushte të njëjta me këto, jeni duke i kontribuar edhe largimit të rinisë nga ky vend. D.m.th. vjen punëtori nga Ferizaji, punësohet në Viti, 2/3 i ke marr. Ti shkon e merr punëtorin 60 vjeçar tash në punë, nuk e merr një të ri. Kjo është përgjegjësia e jote, the jam kryetar partie. Jo ti i ke kaluar 30% të votave të partisë, se të kanë votuar njerëzit se kishe je për qytetarët e Vitisë. Atë moment se je bërë kryetar i Komunës së Vitisë, nuk je ma kryetar i një subjekti politik.

znj.Mirlinda Sadiku: Po të respektohej opozita nja 20 rekomandime që i kemi dhanë për buxhet i kishi marr parasysh, prandaj nuk është që na keni respektuar, edhe ku me ditë se sa për vlerësimin. Ju kam thanë një herë varet kush e bënë vlerësimin. Sa i përket asaj që foli publikisht, gjithmonë mbaj përgjegjësi. Kjo është që ka dal nga Zyra e Prokurimit. Unë kam të drejtë t'i besoj. Zyra e Prokurimit është në mbikëqyrjen tuaj, kish qen mirë kryetar edhe drejtoret me u përgjigj, se kanë mbet shumë pyetje pa përgjigje shumë të rëndësishme. Pse nuk u përgjigje për ujin e kontaminuar në shkolla 1100 nxënësia e pinë ujin e ndotur. Fëmija në klasë të parë nuk e dinë a është i ndotur. Ajo pse nuk mu përgjigje për aneks kontratë, si ka mundësi që shkolla që është milionëshe të mbetet pa roje. Nuk është që nuk keni mundësi, se keni mundësi me kontratë mbi vepër edhe kur të më citoni kam qef me citu taman qysh kam thanë. Unë nuk e thash për zonën ekonomike, nuk thash që është përgjegjësi e jotja. Thash që janë investime të palëve të treta dhe dëgjimet publike që kanë qenë është. Thanë që do të përfundoj në vitin 2018, por edhe ju mbani përgjegjësi, se asaj fjalës tuaj i kanë besuar qytetarët edhe për shkollën e

Pozheranit. Edhe një herë po them, as nuk është higjienike as pedagogjike, se janë grumbulluar nxënës. I keni bërë në tri ndërrime, keni mundësi me përdor edhe shkollën e Qifllakut.

z.Bekim Azizi: Nuk dola me bë replikë, por megjithatë po e bëj një plotësim për përgjigjen që na u dha kryetar. Nuk u dashtë me hap debat, se na i kemi anët ligjore, e kemi raportin dhe kemi me diskutuar, se japim vërejtje. Na bazohemi në atë edhe nëse nuk janë me vend këto vërejtje ti merri serioze se ty të ndihmojnë për të një cilësi ma të madhe. Unë atë që e fola ma herët, gjithçka e fola me letra që na i keni sjellë, sepse zakonisht ju përmbahem letrave. Unë po të them edhe njëherë, se nuk e kam përzier raportin e derivateve. Nëse i krahason raportin e derivateve për gjenerator, për nxemje, edhe për vetura, 60 mijë euro është, unë asgjë nuk kam bërë ma shumë, veç se e kam ba krahasimin e raportit me vitin e parë, që je ardhur, nuk thash që është shumë apo që nuk është shumë. Njëjtë është edhe te harxhimet për dreka zyrtare. Këtu shkruan mbi 30 mijë euro. Unë këtu e lexova vitin e parë, kur je ardh e ke pasur 16 mijë, tash e ke 32 mijë euro. Është një rritje 100%, d.m.th. unë po mendoj se kjo është një vlerë shumë e madhe. A banë nga sot çdo projekt që bëhet me na i sjell me paramasë këtu, edhe pranimin teknik që të kemi na përnjëmend informata. Ju kisha preferuar te komuna e re, ku jeni dal pengesat te tatimi në pronë, që janë tu bërë se e merr faktuarën atje. Duhet me ardh në qytet me ba pagesën edhe prapë me u kthye atje. Besoj se duhet me bë një zgjidhje për këtë.

z.Taulant Haxhiu: Kryetar, unë e kërkova një informatë për shpenzimet, ti më the nuk je shefi im. Unë nuk jam shefi yt, por mua më kanë pruar qytetarët këtu dhe është shumë ligjore që unë me kërkuar një informatë për shpenzimet e informimit publik edhe të drekave zyrtare, por dije një, se këtu nuk je në parti tënden, ti je sjell keq dhe i ke detyruar drejtorat e tu me u tërheqë për shkak konkurseve që i banë qysh të konvenon ty.

z.Njazi Isaku: Unë dola si replikë një minutë, për hire të korrektësisë, për atë shifrën që tha kryetari. Nuk është ashtu rreth 600 mijë euro, por atë shifër unë e kam bazuar te pasqyrat financiare, p.sh.: asfaltimi i rrugëve të gjitha i ke të pasqyruara, plus rregullim i rrugëve me zhavorr. Këto nëse i llogarit afërsisht ta japin atë shumë të cilën e ceka ma herët dhe në fillim, thash atë që e them bazohem në dokumente. Edhe sa i përket punëve për cilësinë e tyre, krejt qytetarët janë ti pa cili është veprimi që je te marr, përveç një rruge te xhamia që e keni pas marr një veprim tjetër, na nuk e dimi që një punë teknike ju nuk e keni pranuar.

znj.Liridona Bislimi: Shumë shkurt desha të ndërlihem te çështja e çerdheve që e përmende kryetar. Ekzistojnë dokumente si të shkruara ashtu edhe video, se gjatë fushatës ju keni premtua ndërtimin e dy çerdheve të tjera, nja ka qenë në Pozheran, një ka qenë këtë pjesë këndeje ka territori i Vitisë. Edhe pyetja që tu ka bërë ty, sa kohë duhet për ndërtimin e çerdheve, ti ke thanë dy vite. Unë këto ditë kam takuar një nanë, që ka një fëmijë 5 vjeçar, dhe ma ka treguar dokumentin që ju ka bërë kërkesë nga psikologu, që ta dërgoj në çerdhe dhe asaj ju ka refuzuar kërkesa, me arsyetimin se nuk ka hapësirë të mjaftueshme, cila është përgjigja juaj karshi kësaj

z.Sokol Haliti: Mua po më vjen mirë që ti këshilltare po insiston vazhdimisht që unë me i realizuar premtimet para qytetareve, se mund të ndodh që jep premtime, por s'mund i realizon 100%, i realizon 87 % ose ma shumë a ma pak. Çerdhet që i kam premtuar realizohen pa gajle. Ne e kemi rivitalizuar çerdhën në viti. Kemi me bërë edhe tjetrën, apo të them se verdiktin edhe vlerësimin e bëjnë qytetarët, tjetër unë nuk jam tu pretendua. Bekim, me i marr përgjegjësitë e krejt dikastereve, por mua më takon një informatë dhe atë po e bëjë. Mirilinda, ti i thua drejtoreshës së Arsimit, e ke shkatërruar arsimin. Në rregull, ti e bënë, po nuk ta pranojnë qytetarët. Ne i kemi edhe pasqyrat financiare që lidhen me pyetjet e parashtruara më herët. Edhe një po ju them, mos mendoni se krejt konkursin që dalin në Komunën e Vitisë i kontrolloj unë. Unë as nuk kam kohë me u marr me ato çështje, janë çështje profesionale. Na po flasim edhe për shërbime shëndetësore, për me punësuar, na po flasim për rini, por na ku mi qua mantilbardhet, ata po punojnë duke ju falënderuar një marrëveshje me Karitasin. Unë e di se çdo objekt të ri na duhet me pas edhe mbikëqyrje. Na kemi me pas problem, edhe palestra, se donë stafe, donë punëtorë. Kryesueses, unë nuk kam ma shumë, un ju falënderoj për debatin, besoj se ishte konstruktiv.

Kryesuesi: Pasi që kemi korum të mjaftueshëm, mendojë që mundemi me vazhdu me pjesën e dytë të seances dhe si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Pasqyrat financiare të buxhetit Komunal janar-dhjetor 2019

Ftoj drejtorin e Financave, që në pika të shkurta të na njoftojë rreth këtyre pasqyrave financiare.

z.Ibrahim Rama: Faleminderit! Kryesues, përshëndetje nënkryetar, përshëndetje të nderuar këshilltar komunal dhe musafir tjerë të pranishëm, përshëndetje edhe për KFOR-in amerikan. Si zakonisht në bazë të ligjeve në fuqi, gjegjësisht në bazë Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe të Investimeve, Kryetari i

Komunës, përmes Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, çdo tre muaj paraqet pasqyrat financiare që kanë të bëjnë për realizimin e buxhetit në periudhat e caktuara. Kësaj radhe, kur është fjala për pasqyrat financiare përfundimtare, që përfshijnë periudhën janar-dhjetor 2019. Në esencë këto pasqyra paraqesin zotimin e buxhetit në bazë të të cilit kanë funksionuar organet komunale, gjegjësisht qeveria komunale në krye me kryetarin e komunës. Pra, këto pasqyra prezantojnë buxhetin e miratuar nga ana e juaj të nderuar këshilltarë komunal. Në vitin 2018, për buxhetin e vitit 2019 dhe në këtë drejtim unë do të mundohem në pika të shkurta në mënyrë që t'iu lë kohë edhe juve për pyetjet rreth këtyre pasqyrave. Në përgjithësi ekzekutimi i buxhetit përcaktohet nga Ministria e Financave, por edhe ligji në përgjithësi i cili ka të bëjë më parë publike. Pra, është ekzekutimi i buxhetit, që për këtë periudhë shprehur në përqindje është në total 99.44%. I shpenzuar sipas kategorisë së shpenzimeve duket kështu: për paga dhe mëditje 99.98%, mallra dhe shërbime 98.6%, shpenzime komunale 99.83%, subvencione dhe transfere 94.3%, investime kapitale 98.67%. Ky konsiderohet si shpenzim solid, që qeveria komunale e ka shpenzuar buxhetin për nga aspekti ligjor saktë dhe në aspektin fizik janë dhënë të gjitha mjetet. Ky buxhet sipas drejtorive shpenzimi i buxhetit është bërë në këtë mënyrë: Zyra e Kryetarit 99.86%, Drejtoria e Administratës 99.63%, Drejtoria e Inspeksionit 99.69%, Zyra e Kuvendit Komunal 99.45%, Drejtoria për Buxhet dhe Financa 98.87%, Drejtoria e Shërbimeve Publike 99.64%, Drejtoria e Bujqësisë 99.38%, Drejtoria e Gjeodezisë 97.93%, Drejtoria e Urbanizmit 99.16%, Drejtoria e Shëndetësisë 99.33%, Drejtoria e Kulturës 96.58% dhe Drejtoria e Arsimit 99.99%. Pra, këto janë përqindjet të cilat paraqesin ekzekutimin e buxhetit, i cili ka qenë në fuqi për vitin 2019. Siç jeni edhe ju në dijeni, që kur formohet buxheti, janë dy burime kryesore grandit qeveritar, diku 89% dhe nga të hyrat vetanake diku afër 11%. Pra, këto janë dy kategoritë të cilat e përbëjnë shumën e përgjithshme të buxhetit. Dhe ky buxhet nëse e krahasojmë si kategori të hyrat vetanake që janë interesante për plotësimin e buxhetit, në këtë vit kemi pasur më shumë të hyra vetanake prej 109.35%. Pra, nga shuma e planifikuar prej 1,043,000.00, janë grumbulluar 1,143,000.00. Nuk duhet të kënaqemi me kaq, duhet të bëjmë më shumë aktivitete të cilat sigurojnë këto të hyra e që ndikojnë në rritjen e buxhetit nga i cili plotësohen nevojat e qytetarëve për investime të caktuara në infrastrukturë direkt prej investimeve të kapitalit. Interesante tjetër është krahasimi i të hyrave vetanake me vitin e kaluar, dhe kur e krahasojmë vitin 2018 me vitin 2019, kemi më shumë të hyra vetanake për 348,533.00 dhe nga gjithë këto të hyra kemi bërë investime kapitale i kemi plotësuar të gjitha ato projekte të cilat kanë qenë të planifikuara nga të hyrat vetanake. Në këtë vit, nga buxheti komunal kemi bërë investime kapitale diku afër 2,216,000.00 në total. Dhe krejt për fund, sa i përket pasqyrave financiare në materialin që keni para jush, keni disa tabela në të cilat shihen kjart ndryshimet e kapitalit. Unë i mirëpres pyetjet e juaja, vërejtjet dhe sugjerimet. Faleminderit për vëmendje!

z.Ali Bajrami: Faleminderit kryesues! Do të jem shumë shkurtë kësaj here, pasi që për pasqyrat financiare foli shumë kjart drejtori i Financave dhe unë këto informata nuk dua ti përsëris. Kjo punë që është bërë për vitin kalendarik janar- dhjetor 2019, ajo që është shumë mirë, që buxhetin e kemi shfrytëzuar 99.43%. Tjetër që kisha cek, është shpenzime i buxhetit sipas drejtorive, dukë përfshirë edhe Zyrën e Kryetarit, buxheti i shpenzuar është mbi 98%. Vlenë të theksohet, se kemi edhe rritje të hyra vetanake, të cilat shfrytëzohen në komunën tonë pikërisht aty ku qytetari ka nevojë më së shumti. Projektet në investime kapitale, edhe kjo është shumë me rëndësi kjo ju hynë në shërbim apo prekë çdo qytetarë të Komunës së Vitisë dhe këto investime i kemi shfrytëzuar 98.5% nga krejt kjo mund të themi që është bërë një punë e mirë në përgjithësi dhe vetëm lutemi që këto punë të mira të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Faleminderit!

z.Njazi Isaku: Faleminderit kryesues! Sa i përket raportit të pasqyrave financiare për vitin 2019, si raport është me rëndësi të veçantë, për arsye se shpalosen të gjitha shpenzimet brenda një viti, si dhe është argument i fuqishëm për neve si asamblist që po flasim për qeverisje dhe kjo na argumenton mënyrën e shpenzimeve të këtij buxheti. Qytetarët e Komunës së Vitisë edhe gjatë këtij viti janë përballur me shumë sfida të reja e të vjetra, për derisa qeverisja komunale vazhdon ti shpërfillë nevojat dhe kërkesat e tyre, ku nga 98 premtime të dhëna vetëm 18 janë realizuar. Këtë informatë e kemi nga instituti GAP. Po ashtu kemi një luks të madh, ku shpenzimet për dreka dhe darka janë rritur, kurse mungesa e transparencës gjatë këtij viti është vërejtur kudo. Kjo qeverisje gjatë këtij viti nuk ka arritur që ti zgjidhë hallet dhe problemet e qytetarëve të cilat janë të panumërta, duke u nisur nga ankesat e nevojave elementare, si: mungesa e ujit në qytet e fshatra, rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, projektet infrastrukturore të cilësisë së dobët. Duke e analizuar këtë raport kemi të njëjtat shqetësime që i kemi ngritur edhe në vitin e kaluar lidhur me disa vija buxhetore se si është shfrytëzuar paraja publike, andaj kemi konstatuar si shpenzime të tepruara luksi, mungesë së transparencës së plotë e detajuar për zërat buxhetorë apo mungesë e

një narrativi për secilën vij buxhetore. Kur e shiqon pasqyrën e buxhetit për vitin 2019, për të gjitha njësitë buxhetore, posaçërisht për disa vija buxhetore, vërejmë një shpenzim të madh të parasë publike. Po ndalem te vijat buxhetore, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit 26,000.00 euro, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit 12,797.00 euro, mëditjet e udhëtimeve jashtë vendit 5,000.00 euro, akomodim gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit 2,481.00, gjithsej si shpenzime kapin vlerën prej 47,257.00 euro, pra këto janë shpenzime luksi. Kalojmë të shpenzimet tjera, si shpenzim tjetër i zakonshëm janë të gjitha drejtoritë, Zyra e Kryetarit është vija buxhetore shpenzime kontraktuese e të tjera që kapin vlerën prej 106,000.00 euro, të cilat tani po dihen bëhet fjalë për punëtorët me kontratë mbi vepër, edhe në këtë vit 2019 ishte i njëjti avaz i shpenzimeve të kjo vij buxhetore që nënkupton se edhe këtë vit po vazhdohet me kontrata mbi vepër, pra tani e kanë obligim ta bëjnë me procedurë të hapur shërbimin kontraktues pikërisht për këtë muaj janar kemi parë një mori kontratash për shërbime kontraktuese, me shpallje të thjeshtëzuara me një afat deri në qershor e që një pjesë e madhe e qytetarëve janë mashtruar duke menduar se po e gjejnë një vend pune ku veç se dihen për kënd po shpallen ato konkurse e ndërsa qytetarët mundohen për të aplikuar. Tek shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparime të mjeteve kemi vlerën 33,866.00 euro, po ashtu janë pajisjet tjera në vlerë prej 77,500.00 euro për cilat pajisje athu bëhet fjalë? Kaq kisha, faleminderit.

z.Bekim Azizi: Faleminderit kryesues! Do të kalojë te një pjesë të cilën e biseduam edhe më herët, por isha ndërlidhur me një formë tjetër, drejtorë te diskutimi të cilin kur është miratuar buxheti për vitin 2019, e ka marrë edhe kartelën analitike të planifikimit dhe në bazë të saj shihen disa tejkalime, përshembull te Zyra e Kryetarit shërbimet e udhëtimit zyrtarë jashtë vendit, nga 6,000.00 euro që kanë qenë të planifikuara, kanë kaluar në 7,790.00 euro. Këto tejkalime a lejohen të ndodhin edhe ka raste tjera shërbimet e kontraktuese tjera te Zyra e Kryetarit janë kanë të parapamë në kartelën analitike të shpenzimeve 11,000.00 euro, ndërsa këtu kemi 33,375.00 euro. Në këtë formë kemi tejkalime tek administrata dhe personeli, ku janë tejkaluara shifrat gati 100%. Kemi te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, edhe këtu kemi tejkalime, për shembull shërbimet teknike 3,500.00 me 6,361.00 vlerë e tejkaluara, për dreka zyrtare janë paraparë të jenë 9,000.00, ndërsa këtu kemi 13,066.00 euro. Këto tejkalime në bazë të asaj si profesionist në këtë lëmi, a lejohen apo është shkelur rregullorja për shpenzimet që kanë qenë të planifikuara në kartelën analitike. Te tatimi në pronë kemi rritje pozitive, duke e ditur që përmbauesit e kanë ndihmuar këtë pjesë, mirëpo ajo është e mbrojtur me ligj. Tek rritja e të hyrave vetanake, kësaj radhe na kishin ndihmuar mjaft shumë dënimet e trafikut me 180,000.00 euro, që ishte një shumë mjaftë e mirë të cilat janë regjistruar si të hyra vetanake. Ndërsa me intereson këto dy qiratë në hapësira publike 13,548.00 euro te planifikuara ndërsa 3,058.00 euro janë të realizuara minus 10,400.00 euro është vlera e mbetur dhe dua ta di pse ka mbetur kjo pa u realizu. Pse këto qira nuk paguhen, cilat janë problemet. Te shitja e masës drunore është një vlerë e vogël, por në krahasim me drutë që janë konfiskuar, unë mendojë që ajo vlerë qaty sillet. Edhe te krahasimi i shpenzimeve, edhe këtu dua të ndërlidhem pak në krahasim me vitin paraprak, furnizimi me lëndë drurore, është diku për 41,000.00 euro më i madh se vitin e kaluar. Nuk e di nëse ka qenë vlera druve kësaj radhe më e lartë apo është marrur sasi më shumë. Te mirëmbajtja e rrugëve lokale, edhe këtu në krahasim me vitin paraprakë kemi rritje gati 100% të vlerës.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje! Jemi në shqyrtim te pasqyrave financiare, te buxhetit komunal për periudhën janar-dhjetor 2019. E kam një pyetje fillimisht për drejtorin e Financave. Dokumentin që na e ke sjell, pohove që bekimi e ka kërkuar, obligimet e pa paguara dhe te hyrat e bartura deri me 31.12.2019. Kam pyetje specifike te shpenzimet e ujit, pasi që në pasqyrat financiare është e cekur që keni shpenzuar për vitin 2019, diku rreth 25,000.00 euro, edhe këtu prapë thuhet që akoma janë te pa paguara te gjitha shpenzimet. A qëndron kjo apo si është çështja. Drejtor, unë ne vitin e kaluar kam bërë lutje që me i nda mjetet paraprakisht për shpenzimet e mbeturave dhe sidomos te ujit, por me theks te veçantë për ujin, për shkak se njësia punuese e ujësjellësit te Vitisë, që dy apo tri vjet del me performanc negative karshi njësisë se Kamenicës dhe Gjilanit dhe vërtet unë po ndihem shumë keq, jam prej Vitisë, ndërsa punoj aty dhe kame një pozicion bukur te mirë në Hidromorave ne Gjilan dhe shpeshherë ndihem shumë keq para kolegeve te mi aty. Lutem që për vitin 2020 te ndërmerreni veprime, duke filluar nga tani ne mënyrë që mos te përsëriten këto gjera, sepse shumë keq kur e mendon që atë ujë e kanë shpenzuar institucionet, siç janë shkollat, shëndetësia, komuna dhe ti s'po e pagun. Kjo i bie shumë keq. Tjeter, ne shikim te pare duket shume mbresëlënëse dhe taman kshtu mu ndi mirë kur ti ke arrit për një vit me ba një dallim aq te madh, me i arketu gati 350,000.00 euro ma shumë sesa ne vitin paraprak, e kjo ne zhargonin e ekonomisë është shumë problem me ndodh, vetëm nëse ka ndodh ndonjë mrekulli edhe tani nëse e

analizojmë mirë raportin, shihet që këtu thjesht 102,000.00 euro janë mbledhur prej lejeve të ndërtimit, ku kemi një bum të ndërtimeve në vitin, ashtu si ka ndodhur edhe në komunat tjera me herët dhe 179,000.00 euro prej gjobave dhe vetëm këto dy pozicione po e bëjnë diferencën që nuk lidhen drejtpërdrejt me personelin zyrtar i cili punon në komunë dhe për këtë kanë vërejtje dhe kanë bërë thirrje shpesh herë Kryetarit i cili duhet pak me ngrit kontrollin tek punëtorët e ti. Sikur ky dallim të kish qene përshembull nga tatimi në prone dhe në disa profile tjera kishte me qene në rregull, megjithatë mirë që ka ndodh. dhe kjo shumë e arkëtuar nga gjobat në trafik në shumë prej 179,000.00 euro brenda një viti. Është për tu brengosur ndoshta kjo me qenë me mirë me e përpiluar një projekt që ndikon në edukimin e qytetarëve mos me marrë aq shumë gjoba në trafik. Megjithatë këto masa kanë qenë të duhura, duke e pasur parasysh edhe numrin e aksidentëve. Dua të ndërlihem edhe të shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, të cilat i përmendi edhe z.Nijaziu. Kemi një rritje afër 9,000.00, sepse me sa e di unë në vitin 2018, shuma në total ka qene 17,065.00 dhe masi ka ndodh kjo rritje a keni ndonjë arsytim pse ka ndodh kjo rritje, ku janë shku ato mjete, a ka mundësi të dokumentohet me pasqyrë. Po ashtu edhe mëditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit janë rritur 100% nga viti i kaluar edhe këtu mungon arsytimi i qartë. Për mua brengosese janë shpenzimet e telefonisë fikse, shpenzimet për internet dhe shpenzimet e telefonisë mobile, kur i mbledhim këto tri pozicione, gjithsej bëjnë 27,414.00 për komunikim brenda. Pse me ndosh gjitha këto shpenzime, kur dihet që në ditët e sodit komunikimi është shumë i lehtë dhe shumë me i mundshëm në mënyra tjera, dhe në disa shtetë të botes telefonia fikse fare nuk perdoret. Franca përshembull eka qkëq krejt telefonin fikse, ndërsa në si komunë i kemi hargju fiks 9,000.00 euro për një vit për këtë lloj telefonie. A duhet patjetër ose a është e nevojshme për çdo vite me ble mobile ka 35,000.00 euro. Përshembull në kompaninë time në vitin 2011 kemi blere mobile në vlerë 25,000.00 euro dhe deri me tani nuk kemi blere me sikur ju çdo vit. Pse me ble pajisje të trafikut në vlerë prej 10,000.00 euro në vitin 2018 ndërsa për vitin 2019 keni blere po këto pajisje në vlerë prej 20,300.00. Një dallim shumë i madh që e kam vërejtur unë të lendet djegëse, megjithatë e dimë që behet me tender publik në vitin 2018 kemi blere lend djegëse në vlerë prej 128,000.00 euro ndërsa për vitin 2019 në vlerë prej 170,000.00. Ky është një dallim gati për 27%, nëse e kthejmë në përqindje dhe ky është dallim shumë i madh. Drekat zyrtare, e ke paraqit vetëm shumën e shpenzuar, por nuk ke bërë ndarje të detajuar për tu bërë e kuart se kush, cilat drejtor apo personel e zyrtar i kanë bërë këto shpenzime, dhe këtu kemi rritje tek këto shpenzime dhe një gjë tjetër për të cilën të lutem nëse ke informata me na njoftu këtu gjatë seancës, është fjala për shpenzimet për vendime të gjykatave 82,000.00 euro, ku në vitin e kaluar kanë qene 14,851.00 euro dhe kjo është një rritje drastike. Të kujt janë këto lëshime, pse po ndodhin këto gjera. Punëkryesit që kanë marrë kontrata dhe kanë ofruar shërbime në Komunën e Vitisë, po shoh që kemi përsëritje të dy apo tri herë të të njëjtit kontraktor dhe një gjë e tillë për mua është shqetësuese, sepse unë punoj që shumë vite në prokurim dhe asnjëherë s'më ka ndodh që i njëjti biznes me marrë dy ose tri herë kontrata brenda vitit. A ka mundësi tjera herë me na sjellë nënshkrimin e marrëveshjes me datë kur është nënshkruar marrëveshja. Faleminderit shumë.

znjMirilinda Sadiku: Kryetar, Nijaziu shumë mirë e elaboroj, por megjithatë unë kam disa pyetje, nëse ka mundësi drejtor me u përgjigj. Realizimi i buxhetit ka tubuar një përqindje mjaftë të lartë, mirëpo me sa e di unë vitin e kaluar vendimet gjyqësore askund si ke paraqit në buxhet. Unë e kam kalkuluar, ndoshta 5 herë këto shpenzime, dhe siç e dimë, ju jeni ekonomist, por mua po më del shuma 152,344.00 euro. Zyra e Kryetarit, Administrata, Kuvendi, unë po bazohem tek këto pasqyrat që na i ke sjellë. E tani nëse një shpenzim i tillë nuk është paraparë në buxhetin e vitit të kaluar, kah janë ardhur këto mjete, këto dikun janë marrur prej ndonjë kodi buxhetor i cili ka mundur me mbet keq, prandaj unë dyshoj të kjo përqindje e shpenzimit të buxhetit, sepse këto nuk i ke pasur të parapame dhe normal që është dashur mi marrë dikur tjetër. Planifikimi dhe shpenzimi që biseduam kur ju thatë që kemi një planifikim dhe shpenzim të mirë. Si mundet me pas planifikim të mirë nëse ka pasur nevojë të bëhen edhe pesë aneks kontrata për vitin 2019, kah janë marr këto mjete. Një pyetje tjetër ka të bëjë pikërisht me tatimin në pronë, unë mendoj që përmbaruesi privat ju ka ndihmuar shumë në këtë aspekt atë për të cilën e kemi diskutuar në fillim të vitit, po më intereson ta di se qytetarët e kanë pasur një sasi të lartë të borxhit publik dhe i cili borxh është në rritje, sa janë paguar këto borxhe të më hershme nëse e ki eventualisht si informatë. Edhe për lejet mjedisore e keni planifikim me i mbledhë 6,850.00 euro, ndërsa këtu në raport e keni zero. Po ashtu edhe të shkolla e mesme profesionale keni planifikuar, më kujtohet shumë mirë kur unë kam bërë vërejtje në draft buxhetin e parë, kur pata thënë a jeni koordinuar me DKA-në, në atë rast për shkollën e mesme profesionale, sepse pikërisht janë kalkuluar dikun rreth 8,134.00 euro, ndërsa këtu ka dalë një përqindje shumë e ulët 9.62%. Kemi rritje të të hyrave, mirëpo edhe rritje të shpenzimeve afër 400,000.00 euro. Dhe më intereson

me ditë, a është ndriçimi publik që ka ndiku në këtë rritje të shpenzimeve, duke i pasur parasysh edhe shpenzimet tjera që përfshihen këtu. Faleminderit.

z.Taulant Haxhiu: I nderuar z.Drejtor, edhe një herë ta bëjë me dije, që unë jam lindur në vitin 1987 e jo në vitin 1982. Unë jam lindur në këtë kohë dhe jam pjesë e kuvendit që dy vite, jam këtu për ti parë dështimet atë të cilën e diskutuam pak më parë, dhe për këtë arsye jam pjesë e këtij kuvendi. Dua ta di për këto mjete në vlerë prej 91,022.00 euro, që janë ndarë për shërbimet kontraktuese për të kryer shërbime të veçanta, a janë kontrata mbi vepër apo ka edhe shërbime të tjera, dhe këtu një pjesë nuk e kamë të qartë, ku thuhet pajisje tjera furnizuese për të gjitha programet në vlerë prej 30,483.00 euro, për çfarë lloj furnizime bëhet fjalë. Për këto dy pyetjet e mia dëshiroj një përgjigje, Faleminderit.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje edhe njëherë! Kemi kërkuar disa shpjegime për këto shërbime të cilat janë nga Karitas Kosova. Shuma më e madhe janë 120,325.00 euro, ndërsa të tjerat janë 934.00 euro. Shërbime të ndryshme shëndetësore janë në vlerë prej 109,765.00 euro edhe tek kjo pjesë kërkojmë sqarime si janë shpenzuar këto mjete. Nxjerrja e monstrave të asfaltit në trupin e rrugës, kontrata ka vlerë 11,920.00 euro. Më sa e di unë, të gjitha rrugët e asfaltuara kanë defekte të mdhaja, të cilat vërehen edhe me anë të syrit, pa bërë analizë fare, dhe dëshiroj të di a kanë bërë këta kontraktues ndonjë analizë apo vetëm e kanë bërë kontratën dhe kurrë s'kanë bërë analiza. Hartuesi i projekteve, Gjeo Map, a mundemi me ditë kush është ky person, sepse aq sa jam në dijeni unë, duke i ditur edhe fjalët e qytetarëve, thuhet se është i njëjti person i cili ka edhe një firmë tjetër dhe që merr punë tjera në komunë. Faleminderit!

z.Ekrem Abazi: Po mundohem me thënë ato të cilat nuk i tha askush më herët nga ana e këshilltarëve, por thuja se të gjithë e kemi mendimin e njëjtë rreth pasqyrave financiare. Të hyrat vetanake 387,000.00, rritje por kur e shikojsha se si ka ndodhë kjo rritje në krahasim me vitin e kaluar, kuptova që shumica e këtyre të hyrave janë ardh si rezultat i gjobave në trafik dhe nga tatimi në pronë. Por dëshiroj të di nëse këto inkasime kanë ndodhur prej borxhit të më hershëm. Tatimi në pronë i planifikuar në vlerë prej 400,000.00 euro. Këto mjete janë inkasuar si rezultat i përmbarueseve privat që i bie i keni marrë me dhunë e unë uroj që i keni marrë prej atyre qytetarëve të cilët kanë pasur borxhe shumë e nuk i keni marr nga qytetarët e varfër të cilët nuk kanë pasur mundësi me bërë pagesën e borxhit. Përmbaruesi i kish marrë vlerë mbi 5,000.00 euro vetëm për me kontribu në këtë drejtim. Nëse ju e cilësoni si sukses këtë gjë, për mua është e dhunshme, sepse unë po besoj që janë marrë prej njerëzve të varfër, por ishalla nuk është ashtu. Të hyrat e planifikuara dhe të realizuara, këto dy terma dallojnë shumë mes vete, sepse tek planifikimi nuk keni bërë planifikim ashtu siç duhet, sepse në disa raste keni bërë tejkalime rreth 500% e në disa tjera as 5 %. Pranimi teknik i lokaleve 2,400.00 janë planifikuar, 4,608.00 janë realizuar, këtu është mirë kjo, është sukses. Te regjistrimi i automjeteve, nuk është ndonjë sukses, sepse është rritur numri i automjeteve, lejet e ndërtimit janë planifikuar 54,000.00 euro janë realizuar 102,383.00 euro d.m.th 189 % nuk isha befasu edhe nëse kjo rite kish me shku deri në 400%, sepse në vitin 2018 janë bërë ndërtime vend e pa vend, ligj e pa ligj, kush ka mujt ka ndërto diku 9.000.00 euro kanë qenë gjatë vitit. Shfrytëzimi i hapësirave publike. Mendoj që është bërë një punë e mirë, sepse unë mundem me dallu punën e mirë dhe jo të mirë. Këtu nga vlera e planifikuar prej 7,000.00 euro, janë realizuar 18,000.00 euro. Shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore të planifikuara, shuma prej 16,250.00 euro, ndërsa janë realizuar 38,433.00 euro, edhe nga kjo nënkuptojmë që është bërë një ndërtim bukur i madh. Gjobat në trafik janë rritur, ky është një sukses për komunën, por e dhimbshme për qytetarin, sepse bukur shumë kishin marrë dënime. Nëse i bëjmë krahasimet tek tatimi në pronë, gjatë vitit 2018 vlera prej 329,000.00 euro, ndërsa për vitin 2019 kemi vlerën prej 434,000.00 euro edhe këtu gëzohem që ka ndodhur kjo rritje. Qiraja nga objektet shëndetësore, a është shtuar ndonjë objekt në vitin 2019 apo gjatë vitit 2018 dikujt nuk i keni marrë qira hiq apo si ka ndodhur kjo rritje. Shfrytëzimi i hapësirës komunale gjatë vitit 2018 kemi vlerën prej 3,972.00 euro, ndërsa në vitin 2019 kemi rritje në vlerë prej 18,000.00 euro, edhe këtu shihet që është bërë një punë e mirë. Donacionet kanë kapur vlerën 69,000.00 euro. Asfaltimi i rrugës që është bërë prej fshatit Skifteraj deri në Stubllen e ulët dhe Goden. Së pari falënderoj tatimpaguesit tanë që kanë kontribu, është bërë një asfaltim mjaftë i mirë edhe pse nuk i plotëson standardet siç duhet me qenë, por në krahasim me atë që po shohë është pak më i dalluar. Rregullimi i rrugëve me zhavorr në vlerë prej 150,000.00 me të vërtetë me duket si shumë bukur e lartë. Hartimi i projekteve në vlerë prej 62,000.00 euro, ju lutem nënkryetar a lejohet që hartimi i projekteve me u bërë nga inxhinierët e tanë dhe nëse po atëherë pse duhet me i bërë të gjitha këto shpenzime për hartim projektësh. E kamë një vërejtje që buxheti

komunal duhet të shfrytëzohet me kohë, kjo vlen edhe për ty aga Ali që po të qeshet, e jo të pritet ne momente të caktuara vetëm atëherë kur duhet ty personalisht për të bërë barazime. Faleminderit!

z.Ali Bajrami: I referohem këshilltarit z.Hekrem, që unë emrin e kam Ali, mirë e ceke, por ama agë nuk jam. Këtë titull nuk e ka pasur kërkush në familje dhe nuk e kamë as unë. Turqia moti kohë ka ikur prej këtu, prandaj të jesh i kujdesshëm me fjalor, sepse s'është e nevojshme që të më etiketosh.

z.Ekrem Abazi: Ali, unë e di që agë s'ke qenë kurrë e as nuk je, por po mundohesh për tu bërë agë.

z.Ibrahim Rama: Janë bërë shumë pyetje, me thënë të drejtën, por unë do të mundohem tu përgjigjem, nuk pretendoj me qenë perfekt edhe pse 35 vite i kam kaluar duke u marrë me financa. Shumë herë edhe kam bërë gabime, por edhe jam munduar me qenë sa më i saktë. Po mundohem mu përgjigj në pyetjet që shumica nga ju i keni bërë pyetjet e njëjta kështu që nuk po ia përmendi emrat të gjithë këshilltarëve. Shumica nga ju keni përmendur shpenzimin e buxhetit për të cilin nuk mund të themi një litër me një litër, fondi në përgjithësi i financave në vlerë prej 12,305,000.00 euro dhe përqindja bëhet në bazë të asaj sa janë shpenzu, sepse pasqyrat financiare paraqesin shpenzim i cili ka ndodhur brenda vitit fiskal prej 1 janar deri me 31 dhjetor 2019, që nënkupton saktësisht shpenzime të cilat kanë ndodhur. Buxheti nuk është llogaritje personale, mos ta lëndon askënd ky buxhet në radhë të parë votohet nga shumica prej juve, qeveria komunale vetëm e bënë përgatitjen e buxhetit dhe ky buxhet a ka arritur apo jo, që t'i plotësojë të gjitha nevojat e qytetarëve mbetet të shihet në të ardhmen. Përndryshe ne gjithmonë bëjmë përpjekje që duke marrë informata jo vetëm prej juve si këshilltarë komunal por edhe prej kryetarëve të fshatrave prej qytetarëve individual dhe të gjitha këto kërkesa mundohemi mi rehabilitu përmes projekteve kapitale që ekzekutohen me buxhetin komunal, i cili miratohet në këtë kuvend. Buxheti nuk është vetëm paga edhe pse ne kemi thënë që diku afër 70 % i buxhetit shpenzohet vetëm për paga dhe pjesa tjetër është për shpenzime kapitale. E pata një vërejtje nga njëri këshilltar i cili tha, që përqindja e buxhetit nuk është koherente me kohën, pse shfrytëzohet në tremujorin e parë, por vetëm në tremujorin e fundit e kështu me radhë. Unë e kam spjeguar shumë herë si dhe një pjesë e ekonomistëve të cilët janë marrë me lëmin e buxhetit, por edhe të firmave private, kuptohet që janë natyra të ndryshme të ekzekutimit të buxhetit. Te investimet kapitale, nuk mundet mu ekzekutu asnjë projekt për tu paguar në tremujorin e parë apo ose në TM1 ndërsa në TM2 vetëm fillon faza e parë e tenderëve, afërsisht krejt kjo është në tremujorin e tretë ose në të katërtin punohet më së shumti. Unë po flasë nga përvoja, se unë nuk jam operator ekonomik e as nuk i bëjë faturat e as përgatitjen e planeve si ka me u shpenzu buxheti në tre mujorin e fundit. Ky është një planë dinamik ku të gjithë operatorët ekonomik varësisht prej kohës kur nënshkruhet kontrata ata paraqesin një planë dinamik kur kanë mu kry projektet dhe zakonisht këtë punë e bënë menaxheri i projektit, mbikëqyrësit në bashkëpunim me organet e komunës dhe me mua si drejtor i zhvillimit ekonomik dhe financave dhe me kryetarin e komunës. Po ju them një të vërtetë të pamohueshme, ku gjatë muajve korrik dhe gushtë ata që punojnë dhe që kanë qëndruar tek zyrat afër që na përcjellin ju kam propozuar kryetarin dhe ai ka vendosë dhe ka punuar në atë kuptim, ku çdo ditë në orën 8 mëngjes kemi mbajtur takim progresi për të gjitha projektet që janë në faza në mënyrë që asnjë operator mos me prit fundit për me ja dhanë mjetet, sepse as un as kryetari as askush nuk ka të drejtë me nënshkru fatur apo zotim të mjeteve pa e bërë verifikimin e mjeteve. E tash a është kry në TM1, TM2, apo TM3, kjo është çështje e ekzekutimit të planit dinamik në këtë drejtim nuk është e drejtë që të akuzohemi as unë si drejtor as kryetari e as qeveria komunale, me rëndësi është që të gjitha faturat e projekteve të cilat paguhet duhet ta ketë mbulesë arsyetimin që punët në teren janë përfunduar, dhe kur krejt kjo të përfundojë sipas hallkave të mbikëqyrësve, atëherë ju dalin mjetet, sepse ne nuk vendosim a me ja lëshu mjetet të hënën apo të shtunën e kështu me radhë. Në këtë drejtim ne gjithmonë tentojmë me qenë korrekt e tash a jemi apo nuk jemi këtë e dëshmon koha dhe organet mbikëqyrëse, unë vetëm e spjegova që në këtë drejtim nuk vendos kryetari me pagu për ndonjë hile apo drejtori financave ose mbikëqyrja me e lanë në momentin e fundit, sepse as në muajin mars e as në dhjetor nuk kemi të drejtë me lëshu pagesë pa mbulesë ose arsyetim, sepse përfundon në burgë. Donacionet në pasqyrat financiare të buxhetit hynë vetëm ato mjete të cilat kanë hyrë si total në buxhet e për me nda saktë duhet secila drejtori pjesën përkatëse me e paraqit të saktë, ndërsa në pasqyra paraqitet vetëm shuma totale vlera si donacion prej 69,000.00 euro e paraqitur në pasqyrë ka qenë vetëm një donacion për një shkollë ku mjetet kanë kaluar në llogari të komunës dhe në bazë të ligjit duhet patjetër mu paraqit në pasqyrat financiare. Të hyrat vetanake, edhe te kjo pjesë kemi shumë për të thënë diku 1,650,000.00 euro qytetarët i kanë borxh Komunës së Vitisë për tatim në pronë jemi munduar me sensibilizim me mjete të informimit me vërejtje të fundit për ti inkasuar këto mjete, sepse është obligim i ynë për ta bërë këtë punë dhe me qenë se ka ardh në

funksion edhe mundësitë juridike në këtë rast përmbartuesi privat dhe kemi marrë masa e kemi dërgu një listë vitin e kaluar dhe një listë tjetër e kam dërguar tash, dhe kur i kam nënshkruar këto lista nuk e ka ditur as kryetari e as unë nuk i kam kontrolluar me rend se kush janë borxhlinjtë, me përdorimin e përmbartuesit ne nuk kemi thy asnjë kriter nuk kemi dashur ta lëndojmë askënd qëllimi ka qenë i mirë. Pyetja tjetër për mostrat e asfaltit. Me ligjet të cilat janë në fuqi, është e lejuar me ligj, që komuna mund ta ketë edhe hartuesin e projekteve edhe mbikëqyrjen vetëm se njëra nga tjetra mos me pas ndikim në punët e tyre, sepse bie në kundërshtim me ligjin. Mirëpo ne po mundohemi me i kursy mjetet financiare të komunës për disa projekte të cilat janë më të lehta për tu kryer, pi angazhojmë disa nga inxhinierët e komunës dhe mbikëqyrjen në total për vitin 2019 e kemi bërë me punëtorët e komunës dhe ne nuk kemi mundur të njëjtën kohë me arrit mi përkufizua të gjitha punët vetëm me inxhinierët e komunës, duke e pasur parasysh edhe kapacitetin e tyre dhe në raste të caktuara shmangies se konflikt interesit. Pyetja tjetër për shërbimet e ndryshme shëndetësore. Ta them të drejtën, unë e di që sot ua kam dorëzuar raportin në plotni, këtu kemi Caritasin e cila ka fituar tenderin për ti kryer këto nevoja shëndetësore për qytetarët dhe ne i kemi bërë pagesën e faturave në bazë të shërbimeve që ajo ika kry dhe si e tillë është shuma që e kemi paraqitur në raport. Për drekat zyrtare në vlerë prej 31,000.00 edhe për këtë ju kam dhënë informata përfaqësuesve të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Demokratike. Pyetja tjetër për specifikacioni i pagesave gjyqësore, të nderuar këshilltarë të kuvendit komunal për këto shërbime kemi paguar gjithsej 155,361.00 euro edhe këtë listë e keni dhe tash mund ti gjeni përgjigjet aty, pra ka të bëjë me pagat jubilarë 90%, një pozicion 14,000.00 euro është dëmshpërblim për aksident në vendin e punës, dhe një rast tjetër është shpronësimi i një prone që Komuna e Vitisë ka pasur nevojë për atë pronë në vlerë prej 13,491.00 euro dhe pjesa tjetër është komplet për paga jubilarë dhe pensioni i punëtorëve. Ju e dini që në vitin 2019 e këna pas buxhetin për këtë kategori ekonomike që është e parapame me kontratë kolektive deri në vitin 2018, ligji ua ka njohur të drejtën dhe unë haptas kamë thënë, mirëpo ne nuk kemi pasur buxhet të planifikum nga Ministria e Financave për ti paguar këto obligime, ndërsa ata po na i marrin mjetet përmes procedurave gjyqësore. Mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe dekorimi i qytetit është 47,016.00 euro dhe pajisjet tjera ku edhe për këtë informatë mundem me sjellë në seancën e ardhshme në mënyrë të detajuar, për ndryshe unë këto shërbime një nga një s'mundem me i mbajtur në mend mundem vetëm si kategori me ditë për çka është shpenzu. Kontratat për punët shitesë, në bazë të ligjeve të cilat janë në fuqi. Çdo projekt ligji e mundëson në vlerë prej 10%, por do të thotë që pa tjetër kjo përqindje të arrihet mundet me qenë varësisht prej natyrës së punës që ka mbetur keq me projekt detal. Shpenzimet për blerjen e druve, blerja apo shitja e druve, te dyat bëhen me thirrje publike. Tu them të drejtën nuk kamë ndonjë shpjegim tjetër varet kur i blejmë drut dhe ai që ofron çmim më të lirë ne i marrim edhe pse ndoshta mundet me qenë prapë i shtrenjtë dhe ne patjetër duhet me u përcaktua me një çmim furnizues. Faleminderit shumë!

z.Ekrem Abazi: Këshilltarë i kryetarit pasi që kryetari më herët nuk u përgjigj. Unë dua ta di a është rregulluar ujësjellësi për Viti-Letnic, sepse një ditë në bazë të një fotografie që e keni postuar ju keni deklaruar që ka përfundua, kinse edhe gypat janë vendos dhe a e keni bërë krejt pagesën. Në qoftë se e keni bërë krejt pagesën, pse nuk po funksionon ai gyp, a duhet për ta dënuar apo për ta shpërblyer këtë punë të keqe që e keni bërë, kush mundet me dhënë llogari për këtë punë, punëkryesi apo mbikëqyrësi. Qytetarët nuk e dinë prej çfarë gypave jemi duke pirë ujë në viti dhe nuk jemi në dijeni nëse akoma keni për të punuar në këtë drejtim apo kjo çështje ka përfundua, she s'po dihet cili është fajtori që ne si qytetarë nuk jemi duke u furnizuar me ujë prej gypave të ri. Edhe po të isha unë fajtori i kësaj pune jo të mirë e kisha dënu vetveten për gjestin e bërë, por edhe ai kushdo qoftë që e ka mbikëqyrë dhe e ka pranua punën si të kryer duhet patjetër të dënohet. Nën kryetari ka deklarua dhe ka thënë që jam duke biseduar me ta nonstop. Kërkova përgjigje edhe më herët, por nuk u përgjigj askush dhe tani dua saktë ta di, sepse është bërë e tepërt kjo puna e ujit. Ndoshta edhe unë e kam tepruar, por lehtë bëhet e ditur arsye se për çfarë arsye nuk është duke funksionuar gypi edhe kaq. Faleminderit!

z.Hasan Aliu: Më lejoni të ju përshëndes të gjithëve, edhe pse tani po hyjmë në orët e mbrëmjes, por megjithatë sot është hera ime e parë që po paraqitem para jush, këshilltarë të nderuar të gjithë ju që po e përcjellni këto punime të kuvendit, që konsiderojë gjithëherë se është njëra prej seancave më të rëndësishme për shkak që bisedohet edhe për harxhimin e buxhetit, për informatën, raport të kryetarit dhe u përgjigj edhe drejtori I Financave në shumë pyetje, të cilat unë konsiderojë se është më profesional për pasqyrat buxhetore, sepse së bashku me stafin e tij të cilët I kanë përgatitur këto për kuvend. Megjithatë unë do të bëjë përpjekje që të përgjigjem në disa prej pyetjeve të juaja që ndoshta drejtorit kanë mundur me shpëtu përgjigjet. Çështja e premtimeve të kryetarit, ku unë ju themë që leni këto gjëra le ti vlerëson qytetari. U tha që nga 98 premtime

vetëm 18 janë realizuar. Në shënime të cilat I mbajë unë, zakonisht nga kjo them se në muajin gusht I vitit 2019 nga 98 premtime vetëm 21 prej tyre nuk kanë filluar akoma të realizohen, dhe unë konsideroj që në vitin 2021 kur edhe përfundon mandati I kryetarit, premtimet do të jenë të realizuara 100%, por këtë gjë e vlerësojnë qytetarët, sepse kryetari është i zgjedhur nga qytetarët, prandaj nuk është mirë që ju këshilltarë të nderuar me diskutu shumë rreth këtyre gjërave. Drekat dhe darkat zyrtare, duhet të jemi parimor, shuma e paraqitur prej 31,000.00 është reale dhe z.Bekimi na ka pas thënë njëherë në formë hajgare, ju po hani dreka shumë, por ju lutem edhe punoni shumë dhe unë i them Bekimit që porosin ta kemi jetësu. Ju lutem duheni të jeni të singert, në vitin 2019 kemi pasur një 14 Qershor, i cili deri më tani nuk ka ndodhur asnjëherë në viti, ku kanë marrë pjesë dy personalitete te njohura, dy ish president që janë ftuar edhe me lejen e juaj, e kemi pasur një veprimtarë që I ka kontribuar shumë popullit shqiptar, është fjala për Xhelil Masën, e kemi organizu edhe një promovim të librit të tij dhe mes tjerash shumë aktivitete tjera të cilit rrisin koston e shpenzimeve për dreka dhe darka zyrtare. Prandaj çdo aktivitet përcillet edhe me shpenzim, por megjithatë opozita i ka këto ankesa, por obligimi im është mi tregu këto gjëra të cilat I kemi ndarë së bashku me ju, edhe ju keni qenë në krenim të 14 Qershorit. Nuk mundeni me thënë mungesë të transparencës. I nderuari z.Nijazi, se përderisa I kemi paraqit në pasqyra financiare të gjitha shpenzimet kjo është vetë transparenca. Shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit nuk kanë të bëjnë me zyrtarë duhesh me dit me bërë dallimin. Janë tjera shpenzime që bëhen për nxënësia e të tjera, ndërsa shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit dhe unë gjithmonë kamë thënë që më pas mundësi këto shpenzime I kisha shtuar më shumë sepse sa herë që ne kemi bërë shpenzime jashtë vendit gjithherë 10 fish janë kthyer ne interes të komunës. Hartuesit dhe implementusit, unë besojë që duhet të respektohet Ligji për Qeverisje Lokale dhe në qoftë se e konsideroni konflikt interesi, janë zyrtarë profesionale që e dëshmojnë një gjë të tillë dhe duhet me ja ndalu aktivitetin asaj kompanie për këtë punë nuk kemi pse diskutojmë. Rrugët me zhavorr në vlerë prej 150,000.00 euro, nuk I kamë parë të gjitha rrugët që janë shtruar vetëm mundem me thënë që është duke u punuar shumë, mesin e tyre edhe nga lokaliteti që jam unë është bërë një punë e mirë e shtruarjes së rrugëve me zhavorr dhe kjo kompania e fund me të cilën kemi punuar në bazë të asaj që kamë parë unë vërtetë është dukë punuar mirë që është për çdo lavdatë. Pagat jubilarë në këtë drejtim unë jam interesuar shumë jo si individ, por jam interesuar për profesorët për shërbyesit civil, janë interesuar edhe komunat tjera dhe ka ndodhë shumë herë kemi biseduar përmes telefonit dhe është bërë një dezinformatë që kinse edhe punëtorët arsimor I kanë marrë këto paga, ndërsa janë paguar punëtorët e shëndetësisë të cilët nuk e kanë dëmtuar buxhetin tonë. Kodi që ka qenë për paga dhe mëditje, në fund Drejtorisë së Shëndetësisë I kanë tepruar dhe drejtoresha së bashku me drejtorin e Financave e kanë bërë një kërkesë në Ministrinë e Financave ku kanë kërkuar për këtë shumën e mbetur ti shfrytëzojmë për paga jubilarë dhe në këtë mënyre ministria I ka leju dhe këta I kanë bërë pagesat. Faleminderit shumë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit për kontributin e dhënë.

Si pike të katërt kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullore për transparencë në Komunën e Vitisë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Ne e kemi përgatit këtë propozim rregullorë e cila i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara dhe para juve kemi sjell për miratim.

Kryesuesi z.Naim Pira Këtë rregullorë e kemi diskutua në KPF-në kjo rregullorë ka qen në debat publik me qytetar unë hapi debat nëse ka për diskutim, a ka dikush për diskutim, pasi që nuk ka e qes në votim për miratim nga të gjithë të pranishmit u miratua kjo pik e rendit të ditës.

Si pike të pestë kemi:

5.Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të Vendimit Nr.01-410/03-52, të datës 01.02.2018, të Komitetit për Politik dhe Financa.

Ju e dini si ka qen marrëveshja para dy vite tani duhet të bëjmë ndryshim plotësimin e këtij vendimi dhe pres propozimet nga ju. PDK-ja e propozon Idajete Pira me qen anëtare e KPF-së, ndërsa LVV-ja e terjak Liridona Bislimi, unë qes në votim për miratim edhe këtë pike të rendit të ditës konstatoj që me votat e të gjithëve u miratua edhe kjo pik e rendit të ditës.

Si pike të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të Vendimit Nr.01-410/03-57, të datës 02.02.2018, të Komitetit për Komunitete.

Edhe këtu kemi të bëjmë me ndërrim të anëtarëve ku në vend të anëtarit Rasim Terziqi shkon Besim Ymeri, kush është që të miratohet ky propozim vendim me votat e të gjithëve u miratua edhe kjo pik e rendit të ditës.

Si pike të shtat të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë.

Materialin e keni pranuar me kohe unë hapi debat për këtë pike, pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim për miratim nga të gjithë të pranishmit u miratua edhe kjo pik e rendit të ditës.

Dhe si pik të fundit e kemi:

8. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimi për ndërrimin e destinimit të parcelave vendimin të cilin e kemi miratua në mbledhjen e fundit e ku ministria e MAPL-së najë ka kthye të kundërligjshëm, unë hapi debat për këtë pike të rendit të ditës.

z.Njazi Isaku: Faleminderit kryesues, shumë shkurtë do të bisedojë në lidhje me për këtë propozim vendim që ndoshta është edhe përgjegjësia e drejtoreshës e cila paraprakisht është dashur të këshillohet edhe me pjesët tjera që janë me rëndësi për komunën siç janë plani rregullativ i komunës që mos të na i nxjerr në lajthitje na me votu këtu një vendim mandej me e shfuqizu për arsye të mos kontrollimit të mirë, ndoshta është dashur ta ketë edhe arsyetimin në mënyrë që ta dimë pse po e bëjmë shfuqizimin e këtij vendimi.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim qes në votim për miratim këtë propozim vendim për shfuqizim të vendim të cekur me larte, nga të gjithë të pranishmit u miratua edhe kjo pike e rendit të ditës, unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë në këtë seance.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 16:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
